



HYRJE NË SIGURIMET BUJQËSORE DHE MENAXHIMIN E RREZIKUT

Doracaku 1

Materiali në këtë punim është i mbrojtur me të drejta autoriale. Kopjimi dhe/ose bartja e pjesëve të kësaj veprë ose veprës së tërë pa leje mund të jetë shkelje e ligjit në fuqi. KNF inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe zakonisht jep leje për riprodhimin e pjesëve të veprës menjëherë, dhe kur riprodhimi është për qëllime arsimore dhe jo komerciale, pa pagesë, me atributet dhe njoftimet që mund t'i kërkojmë me arsye. KNF nuk garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë punim, ose për konkluzionet apo gjykimet e përshkruara këtu dhe nuk pranon përgjegjësi ose detyrim për ndonjë lëshim ose gabim (duke përfshirë, pa kufizim, gabimet tipografike dhe gabimet teknike) në cilëndo përmbajtje ose për t'u bazuar në to. Kufijet, ngjyrat, emërtimet dhe informacione të tjera të paraqitura në hartë në këtë punim nuk nënkuptojnë ndonjë gjykim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori ose miratimin apo pranimin e kufijve të tillë. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë vëllim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore apo të qeverive që ata i përfaqësojnë.

Përmbajtja e këtij punimi është vetëm për qëllim të përgjithshëm informativ dhe nuk ka për qëllim të përbëjë këshilla juridike, të letrave me vlerë ose të investimeve, mendim në lidhje me përshtatshmërinë e ndonjë investimi ose kërkesë të ndonjë lloji. KNF ose bashkëpunëtorët e saj mund të kenë investim në disa prej kompanive dhe palëve (përfshirë ato të përmendura këtu), të ofrojnë këshilla ose shërbime të tjera për to ose të kenë një interes financiar në to.

Të gjitha pyetjet e tjera mbi të drejtat dhe licencat, duke përfshirë të drejtat subsidiare, duhet të drejtohen në Departamentin e Marrëdhënieve të Korporatave të KFN, 2121 Pennsylvania Avenue, N.W., Washington, D.C. 20433.

Korporata Financiare Ndërkombëtare është një organizatë ndërkombëtare e themeluar me Marrëveshje ndërmjet vendeve anëtare të saj dhe është anëtare e Grupit të Bankës Botërore. Të gjithë emrat, logot dhe markat tregtare janë pronë e KFN-së dhe ju nuk mund të përdorni asnjë material të tillë për çfarëdo qëllimi, pa pëlqimin me shkrim të KFN-së. Përveç kësaj, "Korporata Financiare Ndërkombëtare" dhe "KFN" janë marka tregtare të regjistruara të KFN-së dhe mbrohen me ligjin ndërkombëtar.

© Korporata Financiare Ndërkombëtare 2014. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

2121 Pennsylvania Avenue, N.W. Uashington, D.C. 20433 www.ifc.org

Watts dhe Associates, Inc. ("Watts") dhe Instituti Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rrezikut të Bujqësisë ("INMRRB") janë bashkë-autorë dhe së bashku kanë interesin e plotë pronësor në përmbajtjen që e kanë krijuar në materialin që e përmban ky dokument ose prezantim. Interesi i pronësisë e përfshin të gjithë përmbajtjen, e cila përfshin, por nuk kufizohet në teknologjinë, teorinë, konceptet, idetë, strukturën organizative ose çdo përmbajtje tjetër në çfarëdo forme që mund të paraqitet nga dokumentet me shkrim ose prezantimin në të cilin gjendet materiali pronësor. Materiali pronësor i përfshirë në këtë dokument ose prezantim i nënshtrohet marrëveshjeve të konfidencialitetit që ndalojnë botimin, ekspozimin ose shpalosjen e përmbajtjes së pronarit, tërësisht ose pjesërisht, në çdo formë ose media, për çdo person ose subjekt që nuk është i autorizuar nga Watts ose IARM për të parë, shqyrtuar ose për t'u angazhuar në ndonjë diskutim në lidhje me të. Ky material mbrohet me ligjet e SHBA-ve dhe ato ndërkombëtare, nuk mund të kopjohet as tërësisht as pjesërisht dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përcillet nga cilido person i autorizuar të ndonjë palë e tretë që nuk është autorizuar më parë për ta marrë përmbajtjen e këtij materiali. Informacioni në këtë publikim paraqitet në mirëbesim për qëllime të përgjithshme informacioni, dhe as Watts as INMRRB nuk duhet të mbahen përgjegjës për ndonjë nga informacionet e paraqitura këtu. Ky material nuk pretendon të shërbejë si prezantim i plotë i çështjeve të diskutuara këtu dhe nuk duhet të përdoret si bazë për marrjen e vendimeve komerciale.



HYRJE NË SIGURIMET BUJQËSORE DHE MENAXHIMIN E RREZIKUT

NË PARTNERITET ME DONATORËT



GRUPI I BANKËS
BOTËRORE




Tabela e përmbajtjes

Pjesa 1: Hyrje dhe sfondi	8
1.0.Hyrje.....	8
2.0. Përfitimet e sigurimit të kulturave bujqësore	9
3.0. Hyrje në rreziqet në bujqësi.....	10
3.1. Burimet e rrezikut.....	10
3.1.1. Rreziku i prodhimit dhe teknik.....	10
3.1.2. Rreziku i çmimit të produktit dhe faktorëve të prodhimit.	10
3.1.3. Rreziku financiar.....	11
3.1.4. Rreziku politik	11
3.1.5. Rreziku ligjor.	11
3.1.6. Rreziku personal.....	11
3.2. Mjetet e menaxhimit të rrezikut.....	11
3.2.1. Investimet me rrezik të ulët.....	12
3.2.2. Diversifikimi i ndërmarrjeve.....	12
3.2.3. Kapaciteti i tepërt i borxhit	12
3.2.4. Rezervat likuide financiare	12
3.2.5. Të ardhurat nga jashtë fermës	12
3.2.6. Pronësia e ndarë ose prona e marrë me qira	12
3.2.7. Transferimi i rrezikut.....	12
3.2.7.1. Produktet e sigurimeve	12
3.2.7.2. Kontratat.....	12
3.2.7.3. Mbrojtja dhe tregjet e opsioneve.....	12
4.0. Programet qeveritare të menaxhimit të rrezikut	13
5.0. Sigurimet e kulturave bujqësore	14
5.1. Definicionet	14
5.2. Çështjet e lidhura me zhvillimin e produkteve edhe ofrimin e tyre	15
5.2.1. Ofrimi i produktit.	15
5.2.2. Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrje	15
5.2.2.1. Normat e primit	15
5.2.2.2. Zbritjet/mbulimi	15
5.2.3. Strukturat potenciale operative.....	15
5.2.3.1. Agjencitë qeveritare	15
5.2.3.2. Kompanitë private	16
5.2.3.3. Sistemet e përziera.....	16
5.3. Llojet e produkteve të sigurimeve	16
5.3.1. Produktet individuale të sigurimeve.....	16
5.3.1.1. Produktet individuale të sigurimeve bazuar në rendiment	16
5.3.1.2. Produktet individuale të sigurimeve bazuar në të ardhura.....	16
5.3.2. Produktet e indeksit të përafërt.....	16
5.3.2.1. Produktet e tjera të indeksit.....	17

5.4. Palët e interesuara	17
5.4.1. Prodhuesit	17
5.4.2. Siguruesit primarë.....	17
5.4.3. Risiguruesit.....	17
5.4.4. Qeveria.....	17
5.5. Proceset dhe procedurat.....	18
5.5.1. Nënshkrimi	18
5.5.2. Pagesat e primit	19
5.5.3. Korrigjimi i humbjes	19
5.5.4. Pagesa e kompensimit.....	20
5.5.5. Veprimet finale.	20
5.6. Shembull	20

Pjesa 2: Konceptet themelore 22

6.0. Metodatat aktuariale	22
6.1. Norma e rrezikut të pastër	22
6.2. Ngarkesat dhe normat totale të primit.....	23
6.3. Metodatat e vlerësimit	24
6.3.1. Metodatat empirike të vlerësimit	24
6.3.2. Metodatat parametrike të vlerësimit.....	24
6.3.3. Metoda e kombinuar	24
6.3.4. Metodatat e vlerësimit me të dhëna të kufizuara “në terren”	24
7.0. Menaxhimi i të dhënave dhe kontabiliteti	25
7.1. Nevojat për të dhëna.....	25
7.1.1. Prodhuesit	25
7.1.2. Primarë.....	25
7.1.3. Risigurimi	25
7.1.4. Qeveria.....	26
7.1.5. Agjencitë rregullative dhe bordet mbikëqyrëse	26
7.1.6. Bërësit e politikave.....	26
7.2. Mbledhja e të dhënave	26
7.2.1. Niveli i fermës	26
7.2.2. Ofruesit e sigurimeve primare.....	26
7.2.3. Palët e treta private dhe publike	27
7.3. Ruajtja	27
7.4. Qasja	27
7.5. Aktivitetet afariste	27
7.5.1. Ruajtja e dokumenteve (politikat e nënshkruara)	27
7.5.2. Proceset afariste	27
8.0. Nënshkrimi i kontratës së sigurimit dhe korrigjimi i humbjeve	28
8.1. Nënshkrimi i kontratës së sigurimit	28
8.2. Korrigjimi i humbjeve	29
8.2.1. Procedurat.....	29
8.2.1.1. Të korrat biologjike në krahasim me mostrat.....	30

8.2.2. Sistemet e zgjidhjes së kontesteve.....	30
9.0. Risigurimi.....	31
9.1. Hyrje në risigurim.....	31
9.2. Vlerësimi i risigurimit	32
9.2.1. Llojet	32
9.2.1.1. Bashkë-pagesat, bashkë-sigurimi ose pjesëmarrja me përqindje. Bashkë-pagesat.....	32
9.2.1.2. Ndalimi i humbjes	32
9.2.1.3. Risigurimi me shtresa, nivele ose këste	32
9.2.2. Kostot	33
9.3. Grupimi i sigurimeve	33
9.3.1. Produktet e standardizuara	34
9.3.2. Procedurat e standardizuara afariste	34
9.3.3. Korrigjimi i standardizuar i humbjeve.....	34
9.3.4. Mbajtja dhe transferimi i rrezikut të grupit	34
9.3.5. Mekanizmat alternative të transferit të rrezikut.....	34
10.0. Sjellja ilegale.....	35
10.1. Rreziku moral.....	35
10.2. Përzgjedhja e pafavorshme.....	36
10.3. Erozioni i pjesëmarrjes.....	36
10.4. Mashtrimi.....	36
11.0. Përgjegjësitë e qeverisë.....	37
11.1. Rregulloret	37
11.2. Auditimi dhe mbikëqyrja	37
11.3. Gjyqësore dhe ligjore.....	38
11.4. Subvencionet.....	38
11.4.1. Primi dhe shërbimi i subvencioneve.....	38
11.4.2. Risigurimi publik.....	38
11.4.2.1. Përfshirja e qeverisë	39
11.4.2.2. Cilësia e të dhënave	39
11.5. Politikat tregtare dhe ndërkombëtare	39
12.0. Marketingu dhe menaxhimi i programit	40
12.1. Marketingu.....	40
12.1.1. Transparenca e programit	41
12.1.2. Konsistenca e programit	41
12.2. Pjesëmarrja e prodhuesit.....	41
12.2.1. Identifikimi i produktit	41
12.2.2. Edukimi i prodhuesve	42
12.2.3. Shitjet dhe regjistrimi	42
12.2.4. Arkëtimi i primeve.....	42
12.2.5. Korrigjimi i humbjes.....	42
12.2.6. Pagesat e kompensimit.....	43
12.2.7. Zgjidhja e kontesteve	5
12.3. Grupimi i sigurimeve primare	44
12.3.1. Kulturat bujqësore	44

12.3.2. Rendimenti.....	44
12.3.3. Hapësinore.....	44
12.3.4. Praktikat e prodhimit.....	44
12.3.5. Madhësia e fermës.....	44
12.4. Menaxhimi i biznesit.....	45
12.4.1. Operacionet.....	45
12.4.2. Administrata.....	45
12.4.3. Kontabiliteti.....	45
12.4.3.1. Sistemet e teknologjisë informative (TI).....	46
12.4.3.2. Sistemet e biznesit.....	46
12.4.3.3. Procedurat e raportimit.....	46
12.4.3.4. Auditimi.....	46
13.0. Përmbledhje e komenteve.....	47

Parafjala dhe falënderimet

KFN i ka përgatitur pesë doracakë për zhvillimin e tregjeve të sigurimeve bujqësore ku sektori publik dhe privat punojnë së bashku në partneritet (PPP). Doracakët janë të dizajnuar për ta zhvilluar kapacitetin e qeverisë dhe lojtarëve të tregut për të dizajnuar në mënyrë efektive produktet e sigurimeve bujqësore, si kompensimin tradicional ashtu edhe indeksin, për t'i paraqitur ato në treg dhe për zhvillimin e shitjeve. Doracakët janë dizajnuar të jenë koncizë por në të njëjtën kohë të mjaftueshëm për të krijuar bazat teknike dhe administrative për një sistem modern të agro-sigurimeve dhe për të mundësuar që programet në fazat e hershme të zhvillimit ta planifikojnë siç duhet sistemin e kërkuar. Në fund, doracakët janë dizajnuar për t'i trajnuar praktikuesit, për të ndërtuar kapacitetet lokale me aftësitë që kërkohen për ta filluar programin dhe për t'i mundësuar programit të rritet me kalimin e kohës.

Autori kryesor i doracakëve është Profesor Myles Watts, Profesor i Universitetit, Ekspert Kryesor i Sigurimeve në Watts & Associates, Anëtar i Bordit në Korporatën Federale të Hipotekave Bujqësore dhe Bujk i Gjeneratës së 5-të në Montana. Watts dhe Associates kanë dizajnuar dhe futur në përdorim produkte të shumta të agro-sigurimeve në Amerikën e Veriut, shpesh këshillohen për ri-siguruesit më të mëdhenj dhe përkrahin programet e sigurimeve në mbarë botën. Ata kanë themeluar kompaninë e tyre të sigurimeve të indeksit, eWeatherRisk. Doracakët përfshijnë mësimet praktike të mësuara gjatë 40 viteve të fundit.

Zhvillimi i doracakëve ka qenë një aktivitet i përbashkët i projektit të Agro-Sigurimeve në Ukrainë (2007-2015), Ekipit Global të Agro-Financave të KFN-së dhe Fondit Global të Sigurimeve të Indeksit (FGSI) (2009 deri më sot). Dr. Gary Reusche ka udhëhequr projektin e Ukrainës, ka shërbyer si specialist teknik në ekipin global të agro-financave dhe si anëtar i komitetit teknik të FGSI-së dhe ekipit kryesor të menaxhmentit. Zhvillimi i agro-sigurimeve është i lidhur ngushtë me financat bujqësore dhe zinxhirët e vlerës dhe ato zhvillohen së bashku në mënyrë efektive.

Doracakët vijnë si rezultat i punës së punëtorëve të trajnimit të mbajtura nga projekti i agro-sigurimeve në Ukrainë dhe në nivel global nga ekspertët teknikë të FGSI-së. I gjithë ekipi i agro-sigurimeve në Ukrainë ka dhënë kontribute praktike në doracakë, me një falënderim të veçantë për Victoria Yakubovich për mbledhjen, organizimin dhe përgatitjen e drafteve fillestare dhe për Andrey Zaripov, anëtar i ekipit të FGSI-së për ndihmën në zhvillimin e modeleve të risigurimit dhe të rrjedhës së parave. Ekipi i projektit ka përfshirë ekspertë nga programi bujqësor provincial në Alberta (Kanada), në veçanti Richard McConnell, i cili kontribuoi me përvojën dhe ekspertizën e tij në aktivitetet e trajnimit.

Shqyrtimi nga kolegët dhe përkthimet në gjuhën spanjolle të doracakut vijnë nga konsulentët e BNRZH-së në Amerikën Qendrore dhe Jugore, veçanërisht Pablo R. Valdivia Zelaya dhe Roberto Dario Bacchini.

Ekipi i është mirënjohës Profesorit Gary Brester për kontributin e tij praktik dhe redaktimin e doracakëve dhe Olesya Zhuchenkos për koordinimin e botimit të doracakëve, për punën me dizajnerët për ta planifikuar paraqitjen dhe shtypjen.

Më në fund, përkrahja për doracakët është siguruar nga qeveria kanadeze dhe nga Fondi Global për Sigurimet e Indeksit (FGSI), kryesuar nga Gilles Jacques Galludec (Menaxher i Programit) dhe financuar nga Bashkimi Evropian, Japonia dhe Holanda.

Shkurtesat

KNF – Korporata ndërkombëtare financiare GIIIF – Indeksi global i sigurimeve

DFATD – Punët e jashtme tregtia dhe zhvillimi Kanada

IIARM – Instituti ndërkombëtare për menaxhimin e rrezikut në bujqësi

BE – Bashkimi Evropian

GATT – Marrëveshja e përgjithshme për tarifatat dhe tregtinë

HA – Hektar

TI – teknologjia e informacionit

RMA e USDA– Departamenti i Bujqësisë i Shteteve të Bashkuara, Agjencia për Menaxhimin e Rrezikut

OBT – Organizata Botërore e Tregtisë

UAH – Hryvni të Ukrainës, njësia monetare e Ukrainës

Pjesa 1: Hyrje dhe sfondi

1.0. Hyrje

Në këtë doracak prezantohen dhe diskutohen sigurimet në bujqësi dhe ofrohen metoda për zhvillimin, menaxhimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e programeve të tilla. Sigurimet në bujqësi përfshijnë shumë lloje të produkteve, duke përfshirë të pronës, shkakut, jetës dhe sigurimin shëndetësor. Gjatë gjithë doracakut, termi "sigurime në bujqësi" do të thotë programet e sigurimit të kulturave bujqësore (dhe në disa raste edhe bagëtisë).

Programet e suksesshme të sigurimeve bujqësore duhet të ndërtohen me kujdes përpara fillimit të tyre dhe të përshtaten me rrethanat unike të vendeve dhe rajoneve të veçanta; programet e sigurimit të dizajnuara dobët do të dështojnë dhe do të krijojnë humbje për palët e përfshira, duke krijuar mosbesim në mesin e prodhuesve dhe publikut. Programet e suksesshme duhet të frymëzojnë një shkallë të lartë të besimit në mesin e të gjitha palëve të interesuara.

Transparenca është me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe ruajtjen e besimit në programet e sigurimeve bujqësore. Arritja e kësaj transparence është e mundur vetëm kur të gjithë aktorët marrin pjesë në debatin e hapur dhe e kuptojnë procesin e sigurimit. Komunikimi i qartë u mundëson palëve të interesuara të hartojnë programe që plotësojnë nevojat e përdoruesve të tyre dhe ndihmojnë në parandalimin e ndërlikimeve afatgjata. Gjatë gjithë këtij dokumenti, theksi vihet në transparencën në të gjitha nivelet, nga fermerët deri te siguruesit privatë dhe agjencitë qeveritare që i përkrahin dhe vendosin rregulloret për këto programe.

Duke përdorur shembuj nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanada, ky dokument trajton një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë strukturën e programit, stimulimet për pjesëmarrje, rolin e kompanive të sigurimeve dhe risigurimeve dhe rolin e agjencive qeveritare në sigurimin dhe përkrahjen e programeve të sigurimit të kulturave bujqësore dhe subvencionet.



2.0. Përfitimet nga sigurimi i kulturave bujqësore

Ofrimi i kredive për prodhuesit bujqësorë ndryshon ndjeshëm nga llojet e tjera të huadhënies në biznes. Dallimi më i dukshëm ndodh për shkak të sezonalitetit të hyrjeve të parave në shumë aktivitete bujqësore. Edhe pse daljet e parave zakonisht ndodhin përgjatë vitit në shumicën e aktiviteteve bujqësore, hyrjet e parave mund të paraqiten vetëm disa herë (dhe shpesh, vetëm një herë) gjatë vitit. Hyrjet e parave që zakonisht ndodhin në periudha të caktuara në bujqësinë e prodhimit krijojnë nevojën për linjat kreditore operative. Si pasojë, sigurimi i kulturave bujqësore mund të jetë një komponent i rëndësishëm i marrjes së kredive dhe qasjes në kredi. Përveç kësaj, për shkak se shumë mjete të punës kërkojnë shpenzime të mëdha fillestare që pritet të japin përfitimë gjatë shumë viteve, nevoja për financim afatmesëm për rritjen e bagëtive, makineri dhe ndërtesa shpesh është e madhe. Duke pasur parasysh se hyrjet e parave shpesh ndodhin vetëm sporadikisht brenda vitit, dështimi në kultura bujqësore mund të ketë si rezultat rrezik të menjëhershëm të mospagesës së kredisë. Një praktikë e zakonshme e huadhënies komerciale është të "klasifikohen" kreditë që nuk i kanë të kryera pagesat tërësisht gjatë 90 ditëve të kaluara siç specifikohet në kontratë. Megjithatë, në bujqësi, nëse nuk paguhet vetëm një pagesë e vetme e kredisë kjo ka si rezultat që kredia të bëhet "e klasifikuar". Në shumicën e situatave të tjera të kredidhënies për biznese, hyrjet e parave janë më të rregullta dhe nëse nuk pranohen paratë në një rast të vetëm, kjo nuk ndikon në mënyrë dramatike në pagesën e kredisë. Megjithëse një biznes prodhimi bujqësor mund të jetë profitabil në planin afatgjatë, një vit i vetëm në të cilin ndodh moti ekstrem ose çmimet e ulëta të tregut mund të shkaktojnë mospagesë të kredisë. Rrjedhimisht, prodhimi bujqësor shpesh paraqet një rrezik të lartë afatshkurtër kreditor për shkak të kombinimit të kostove të larta fikse, ndryshueshmërisë së motit dhe sëmundjeve, si dhe variacioneve në pranimet e parave.

Qeveritë shpesh përfshihen në shumë aspekte të ofrimit të sigurimit bujqësor. Përveç zvogëlimit të ndryshueshmërisë së të ardhurave në ferma, çështje të tjera sociale shpesh citohen si arsye për përfshirjen e qeverisë.

Për shembull, trazirat sociale në shumë vende në zhvillim shpesh shoqërohen me prodhim dhe të ardhura të ulëta - sidomos për fermerët që varen nga puna e tyre për ekzistencë. Shumë vende në zhvillim varen nga një ekonomi e shëndoshë e fermave si një mjet për gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet eksporteve bujqësore.

Për më tepër, shumë çështje sociale përkeqësohen për shkak të emigrimit nga zonat rurale në rajonet urbane. Ky migrim rritet në vitet



kur fermat kanë prodhim të ulët. Shumë zona rurale do të përfitonin nga përdorimi i teknologjive moderne. Megjithatë, duhet kohë dhe burime financiare për të blerë dhe mësuar teknologji të reja. Në mungesë të niveleve të të ardhurave që garantohen nga sigurimi i kulturave bujqësore, teknologjitë e reja me rrezik rrallë përdoren edhe nëse këto teknologji do ta përmirësonin mirëqenien e prodhuesve. Në fund, shumë vende inkurajojnë pjesëmarrjen e lartë në sigurimet bujqësore për ta zvogëluar nevojën për programe ad hoc kundër fatkeqësive të cilat zakonisht janë të shtrenjta, joefektive dhe joefikase.

3.0. Hyrje në rreziqet në bujqësi

Prodhuesit bujqësorë përballen me një sërë rreziqesh dhe me pasiguri të konsiderueshme. Kjo pjesë identifikon dhe përcakton burimet dhe llojet e rreziqeve bujqësore, si dhe mjetet në dispozicion për t'i menaxhuar ato rreziqe.

3.1. Burimet e rrezikut

Prodhuesit bujqësorë përballen me një sërë rreziqesh përfshirë rrezikun e rendimentit, të çmimit të prodhimit dhe të çmimit të faktorëve të prodhimit. Disa nga këto rreziqe menaxhohen përmes prodhimit dhe vendimmarrjes financiare, ndërsa të tjerat thjesht pranohen si shpenzime biznesi. Disa rreziqe mund të menaxhohen përmes një sërë produktesh kontraktuale dhe të lidhura me sigurimet. Në shumë raste, megjithatë, disa rreziqe janë të vështira për t'u përmirësuar, si ato që lidhen me marrëdhëniet ndërpersonale që mund të krijojnë stres personal fizik, emocional dhe financiar në familjet e fermerëve dhe punonjësve të tyre. Kjo pjesë diskuton burimet e rrezikut bujqësor.

3.1.1. Rreziku teknik dhe i prodhimit shkaktohen kryesisht nga sëmundjet dhe kushtet ekstreme të klimës, duke përfshirë thatësitat ose reshjet e pakta, reshjet e tepërta ose vërshimi në kohën e mbjelljes (pengon mbjelljen), reshjet ose acar në ose pak para korrisjes (vonohet vjelja, mbirja), erën, insektet ose breshërin. Ndryshe nga shumë situata të tjera të prodhimit, përdorimi i sasive dhe cilësive specifike të faktorëve të prodhimit në një proces të prodhimit bujqësor mund të ketë rezultate të ndryshme varësisht nga moti, insektet, barërat e këqija, dhe një shumëllojshmëri të gjerë të ndërveprimeve ndërmjet këtyre dhe faktorëve të tjerë. Ndryshimet në teknologji paraqesin një aspekt tjetër të rrezikut teknik. Miratimi i një teknologjie të re në vetvete është me rrezik, por mosarritja për të zbatuar teknologji të reja dhe të suksesshme gjithashtu krijon rrezikun që të mos jenë konkurrues në një ekonomi globale.

3.1.2. Rreziku i prodhimit dhe faktorëve të prodhimit

është i konsiderueshëm në tregjet bujqësore për shkak të faktorëve botërorë të ofertës dhe kërkesës. Çmimet e mallrave bujqësore që tregtohen gjerësisht ndërmjet shteteve i nënshtrohen veçanërisht kushteve të tregut botëror. Ndryshimet në transport, magazinim dhe shpenzimet e faktorëve të prodhimit gjithashtu shtojnë ndryshueshmërinë e çmimeve të vendit.

Shembull: Në tetë vitet e fundit, luhajtjet në nivelet e prodhimit të grurit në botë kanë shkaktuar që çmimi i grurit të ndryshojë ndërmjet 100 \$ për ton dhe 300 \$ për ton.



Rreziku i çmimeve të faktorëve të prodhimit ndodh sepse çmimet e faktorëve të prodhimeve bujqësore shpesh ndryshojnë konsiderueshëm me kalimin e kohës. Çmimet e karburanteve, plehrave dhe kimikateve bujqësore luhaten si rezultat i ndryshimeve në kërkesën për përdorim në bujqësi dhe përdorim jo-bujqësor dhe për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe prodhimin botëror.

Shembull: Çmimi i naftës u dyfishua gjatë dymbëdhjetë muajve (tetor 2007

- tetor 2008) në Shtetet e Bashkuara. Gjatë të njëjtës periudhë, çmimi i plehut u rrit për 250%. Çmimi i naftës së papërpunuar ndikon në çmimet e derivateve të naftës ndërkohë që çmimi i gazit natyror ndikon në çmimet e plehrave të azotit. Rritjet e çmimeve për këta faktorë primarë ndikojnë në profitabilitetin e prodhuesve bujqësorë.

3.1.3. Rreziku financiar në përgjithësi i referohet ndryshueshmërisë së të ardhurave neto të fermës gjatë një periudhe specifike kohore (shpesh një vit ose një cikël prodhimi) dhe është brengë e madhe për prodhuesit bujqësorë, furnizuesit dhe agrobizneset. Mesatarisht, të ardhurat vjetore neto të fermave mund të jenë të mjaftueshme që prodhuesit bujqësorë të realizojnë fitime, por ndryshueshmëria e të ardhurave mund të shkaktojë që disa prodhues bujqësorë të dështojnë. Nëse të ardhurat neto të fermës janë të vogla ose negative në një vit të caktuar, prodhuesi ka gjasa se do të përballet me vështirësi financiare. Të ardhurat e paqëndrueshme neto të fermës janë veçanërisht të vështira për fermerët. Menaxhimi i rrezikut financiar është veçanërisht i rëndësishëm për prodhuesit bujqësorë që marrin kredi afatshkurtër ose afatgjatë, ku kërkohen pagesat e interesit dhe principalit me plan të caktuar.

3.1.4. Rreziku politik rrjedh nga ndryshimi i veprimeve rregullative dhe qeveritare, pasi ato lidhen me çështjet mjedisore, praktikat afariste, çështjet financiare, marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare dhe programet e përkrahjes së qeverisë. Çështjet e tilla janë relevante madje edhe në kuadër të sistemeve politike të qëndrueshme dhe të stabilizuara.

3.1.5. Rreziku ligjor është i rëndësishëm për aspekte të shumta të prodhimit bujqësor. Për shembull, firmat e prodhimit bujqësor mund të kenë detyrime të ndryshme që rezultojnë nga degradimi i mjedisit, ndotja e ajrit dhe zhurma, ndërprerja jo e duhur e kontratës, lëndimi, përmbushja e kontratave dhe të drejtat pronësore.

3.1.6. Rreziku personal përfshin rrezikun e lëndimit, sëmundjes ose vdekjes së menaxherëve apo punonjësve. Bujqësia e prodhimit është profesion me rrezik. Shkurorëzimi dhe përkeqësimi i marrëdhënieve të tjera personale gjithashtu mund të shkaktojnë probleme financiare.

3.2. Mjetet e menaxhimit të rrezikut

Prodhuesit bujqësorë përdorin një sërë teknikash për ta menaxhuar luhatshmërinë e të ardhurave neto të fermës. Në përgjithësi, kostot e faktorëve të prodhimit bujqësor dhe përdorimi i tyre janë shumë më të qëndrueshme nga viti në vit sesa çmimet e mallrave dhe rendimentet. Përpjekjet për ta ulur luhatshmërinë e të ardhurave neto, prandaj, përqendrohen në rendiment dhe në rrezikun e çmimeve të produkteve.

Prodhuesit bujqësorë përdorin një sërë strategjish për t'i menaxhuar rreziqet financiare duke përfshirë investimet në ndërmarrjet me rrezik më të ulët, diversifikimin e ndërmarrjeve, mbajtjen e raportit relativisht të ulët të borxhit ndaj aseteve dhe mbajtjen e rezervave adekuate financiare dhe zhvillimin e burimeve të të ardhurave nga jashtë fermës.



3.2.1. Investimet me rrezik të ulët janë një metodë për menaxhimin e rrezikut. Do të thotë, rreziku mund të ulët duke shmangur veprimtaritë me rrezik të lartë. Investimet në aktivitete me rrezik të ulët, megjithatë, lidhen zakonisht me kthim mesatar relativisht të ulët në krahasim me investimet me rrezik më të lartë.

3.2.2. Diversifikimi i aktiviteteve është një teknikë e menaxhimit të rrezikut që përfshin investimin në shumëllojshmëri të investimeve që nuk kanë korrelacion perfekt me njëra-tjetrën brenda një portfolioje. Kombinimi i investimeve që nuk kanë korrelacion të lartë ndërmjet vete zvogëlon luhatshmërinë e kthimeve dhe mund të mundësojë që të mbahen kthimet mesatare në nivel të duhur. Shumë fermerë prodhojnë lloje të ndryshme të produkteve bujqësore dhe blegtorale si një metodë për diversifikim; shumë prej këtyre teknikave të diversifikimit gjithashtu prodhojnë përfitime të shtuara përmes përmirësimit të karakteristikave të dheut, zvogëlimit të barërave të këqija dhe kufizimit të infektiveve nga insektet. Çmimet e shumë mallrave bujqësore shpesh kanë korrelacion pozitiv ndërmjet vete, gjë që kufizon përfitimet e diversifikimit nga prodhimi i shumë llojeve të kulturave bujqësore. Përveç kësaj, rendimentet priren të kenë korrelacion pozitiv në të gjitha kulturat gjë që e kufizon vlerën e diversifikimit të kulturave bujqësore. Për këto arsye, shumë prodhues bujqësorë diversifikohen në mallra blegtorale dhe ato bujqësore.

3.2.3. Kapaciteti i tepërt i borxhit. Prodhuesit bujqësorë në përgjithësi mbajnë raport relativisht të ulët borxh-asete si një metodë për ta ulur rrezikun financiar; bujku mesatar në Shtetet e Bashkuara mban raport të borxhit ndaj asetëve prej afërsisht 10%, që është një raport shumë më i ulët sesa agrobizneset e tjera. Raporti i ulët i borxhit ndaj asetëve është i domosdoshëm për shkak të kostove të larta fikse (shpenzimet që nuk ndryshojnë sipas nivelit të prodhimit) dhe sezonalitetit të të ardhurave. Pjesa më e madhe e rrezikut financiar të përfshirë në bujqësinë e prodhimit është rezultat i natyrës sezonale të produkteve dhe, rrjedhimisht, gjenerimit sezonal të të ardhurave.

3.2.4. Rezervat likuide financiare. Shumë prodhues bujqësorë mbajnë rezerva të konsiderueshme financiare ose mjete likuide për të ndihmuar në uljen e efekteve të sezonalitetit dhe zvogëlimin e rrezikut financiar duke përfshirë rrezikun e dështimit të kulturave bujqësore.

3.2.5. Të ardhurat nga jashtë fermës. Prodhuesit bujqësorë dhe anëtarët e tyre të familjes shpesh punojnë në punë jashtë fermës. Nëntë nga çdo dhjetë familje bujqësore në Shtetet e Bashkuara kanë ndonjë të ardhur nga jashtë fermës që siguron një burim më të qëndrueshëm dhe potencialisht jo-sezonal të të ardhurave. Këto mundësi punësimi mund të ofrojnë përfitime shtesë duke përfshirë qasjen në sigurim shëndetësor grupor dhe sigurimin e jetës.

3.2.6. Pronësia e përbashkët ose marrja me qira i asetëve të prodhimit bëhet në disa mënyra. Në përgjithësi, dikush tjetër dhe jo menaxheri i fermës/rançit mund të jetë pronari i të gjitha ose një përqindjeje të asetëve prodhuese të një ferme. Toka, ndërtesat, kafshët dhe makineritë mund të jenë pjesërisht ose tërësisht në pronësi të një personi tjetër dhe jo menaxherit të fermës/rançit. Në shumë raste, këto asete janë marrë me qira nga operatori i fermës që e ul rrezikun financiar të atij operatori për shkak të uljes së investimeve kapitale dhe nevojave më të pakta për kredi.

3.2.7. Transferimi i rrezikut mund të largojë disa nga rreziqet që lidhen me prodhimin bujqësor nga prodhuesi, por nuk është pa shpenzimet e veta. Prodhuesit bujqësorë e transferojnë rrezikun tek palët e tjera në mënyra të ndryshme duke përfshirë përdorimin e tregjeve formale të sigurimeve, tregjet e kontratave të ardhme dhe opsioneve, dhe kontratat.

3.2.7.1. Produktet e sigurimeve ndihmojnë në uljen e rrezikut. Për shembull, tregjet formale të sigurimeve të pronës e transferojnë rrezikun nga prodhuesit tek të tjerët për sa i përket zjarrit, erës, vjedhjes dhe rreziqeve të tjera mbi ndërtesat, makineritë dhe kafshët. Më tutje, produktet e sigurimit të shëndetit dhe jetës përdoren për ta menaxhuar rrezikun personal. Primet e paguara për kompanitë e sigurimeve për transferimin e këtij rreziku përfaqësojnë kostot e transferimit të rrezikut. Përveç kësaj, sigurimi i rendimenteve mund ta kompensojë rrezikun e prodhimit dhe sigurimi i të hyrave mund të kompensojë kombinimet e rrezikut të rendimenteve dhe të çmimeve.

3.2.7.2. Kontratat. Disa prodhues kontraktjnë më herët shpërndarjen e kulturave bujqësore të tyre dhe bagëtime të subjekte të ndryshme të agrobiznesit. Në shumicën e rasteve, kontratat paraprake parashohin çmimet specifike që duhet të paguhet pas dorëzimit të mallit. Kontratat shpesh përfshijnë një shumëllojshmëri të specifikimeve të cilësisë dhe janë ligjërish të zbatueshme. Përveç kësaj, prodhuesit mund t'i kontraktjnë më herët edhe faktorët e prodhimit bujqësor.

3.2.7.3. Mbrojtja dhe tregjet e opsioneve. Tregjet formale të kontratave të ardhme (futures) të mallrave ofrojnë mundësi për menaxhimin e rrezikut të çmimeve të faktorëve dhe të prodhimit. Njësoj si kontraktimi paraprak, tregjet e kontratave të ardhme për mallra mund të përdoren për të përcaktuar më herët çmimet e shitjes. Ndryshe nga kontraktimi paraprak, rreziku bazë (diferenca ndërmjet çmimeve në një treg të kontratave të ardhme të mallrave dhe çmimeve lokale) mund të ndryshojë çmimet e shitjeve neto, por ndryshueshmëria e bazës përgjithësisht është shumë më e ulët se ndryshueshmëria e çmimeve të mallrave.

Në rastin e opsioneve të shitjes, tregjet e opsioneve të mallrave ofrojnë një lloj tjetër të sigurimit të çmimeve duke vendosur një minimum të çmimit (në këmbim të një pagese primi) pa vendosur kufizime në rritjen e mundshme të çmimeve. Opsionet e blerjes vendosin një maksimum të çmimit për çmimet e faktorëve të prodhimit pa kufizuar fitimet që mund të arrihen nga rënia e çmimeve. Opsionet e shitjes dhe blerjes në përgjithësi tregtohen për mallrat për të cilat ekzistojnë tregjet e kontratave të ardhme (futures).

4.0. Programet qeveritare të menaxhimit të rrezikut

Në shumë vende të zhvilluara, shumë lloje të programeve qeveritare ofrojnë mbrojtje nga rreziku financiar për prodhuesit bujqësorë. Në disa vende, të tilla si Japonia, këto programe i përcaktojnë çmimet minimale për mallrat bujqësore. Në Shtetet e Bashkuara, ofrohen pagesat e programeve kundërciklike për prodhuesit për të kompensuar në periudhat e çmimeve të ulëta. Duke pasur parasysh çmimet e larta të mallrave në mbarë botën, programet kundërciklike nuk janë zbatuar gjatë disa viteve të fundit (përveç për pambuk).

Programet për përkrahje të çmimeve dhe të ardhurave në bujqësi ndikojnë në stimulim të prodhuesve për të marrë pjesë në sigurimin bujqësor. Këto programe ofrojnë garanci të çmimeve minimale dhe një shumëllojshmëri të përkrahjes me të ardhura në fermë për prodhuesit e disa mallrave. Programet që ofrojnë përkrahje të çmimeve minimale ose pagesa kundërciklike për mallrat e caktuara e zvogëlojnë rrezikun financiar duke ulur ndryshueshmërinë e çmimeve dhe ofrojnë pagesa direkte që rrisin rezervat financiare të prodhuesve. Këto programe të zvogëlimit të rrezikut ulin stimulimet që prodhuesit të blejnë sigurimin e kulturave bujqësore. Për të ruajtur normat e pjesëmarrjes, disa qeveri kërkojnë që prodhuesit të blejnë sigurim të kulturave bujqësore si një parakusht për marrjen e përfitimeve të përkrahjes së të ardhurave. Përveç kësaj, pjesëmarrja në programet e sigurimeve bujqësore mund ta bëjë më të lehtë të merren kredi për shkak të zvogëlimit përkatës të rrezikut të mospagesës.

Shumë vende ofrojnë programe *ad hoc* të **Ndihmës në rast katastrofash** që i kompensojnë humbjet e shkaktuara nga ndodhitë katastrofale të motit. Programet qeveritare të emergjencës ose të ndihmës në raste fatkeqësish ofrojnë ndihmë për prodhuesit bujqësorë në rast të ngjarjeve katastrofike, si vërshimat e mëdha, thatësitrat, uraganet ose tornadot. Janë bërë hulumtime të konsiderueshme mbi efektin e programeve kundër fatkeqësive në gatishmërinë e fermerëve për të blerë sigurimin e kulturave bujqësore. Në përgjithësi, prodhuesit bujqësorë, të cilët janë relativisht të sigurt se qeveria e tyre do të ofrojë ndihmë financiare pas një fatkeqësie natyrore, ngurrojnë më shumë për të blerë sigurimin e kulturave bujqësore. Programet *ad hoc* shpesh kanë kosto të konsiderueshme administrative, sepse çdo katastrofë e re mund të kërkojë ndërtimin e strukturave administrative dhe operacionale.



5.0. Sigurimi i kulturave bujqësore

Dallimi kryesor ndërmjet sigurimit të kulturave bujqësore dhe llojeve të tjera të sigurimit të pronës përfshin monitorimin dhe vlerësimin. Për shkak të efekteve të motit dhe atyre biologjike, humbjet në kultura bujqësore janë shumë më të kushtueshme që të monitorohen se shumica e formave të tjera të sigurimit të pronës. Për më tepër, çmimet që përdoren për të kompensuar humbjet ndryshojnë konsiderueshëm në kohë dhe hapësirë. Nevojitet sasi e konsiderueshme e të dhënave me cilësi të lartë për të vendosur normat e primeve me arsyeshmëri aktuariale. Shumëllojshmëria e gjerë e produkteve të sigurimit të kulturave bujqësore, mekanizmat aktivizues dhe çështjet e politikave publike i komplikojnë programet e sigurimit të kulturave bujqësore.

5.1. Përkufizimet

Duhet të përcaktohen disa kushte sigurimi të kulturave bujqësore për t'i kuptuar çështjet që lidhen me ofrimin e programeve të sigurimit të kulturave bujqësore. **Ofruesi i sigurimit** është një subjekt që është i gatshëm të ofrojë mbulim me sigurim në këmbim të një tarife (ose primi). Ofruesit e sigurimeve përfshijnë agjencitë lëshuese dhe risiguruesit. **Agjencitë lëshuese**, ndonjëherë të quajtura sigurues primarë, i vendosin në treg dhe i menaxhojnë kontratat e sigurimit për të siguruarit. **Risiguruesit** zakonisht janë kompani sigurimi shumë të mëdha (ose disa raste, qeveri) që janë të diversifikuara mirë në të gjithë hapësirën, sektorin dhe llojet e sigurimeve dhe që kanë rezerva financiare të konsiderueshme që ofrojnë kapacitet për të paguar kompensimet.

Primet përfaqësojnë çmimin që blerësi i sigurimit ia paguan një agjencie lëshuese për të marrë një polisë sigurimi. Transaksioni i tregut në të cilin ofruesi i sigurimit është i gatshëm ta pranojë rrezikun nëpërmjet dhënies së një kontrate sigurimi (në këmbim për një tarifë) është mekanizëm i **transferimit të rrezikut**. **Vlerësim** quhet procesi i krijimit të primeve të sigurimit që kanë arsyeshmëri aktuariale.

Arsyeshmëria aktuariale nënkupton që me kalimin e kohës, mbledhja e primeve është e mjaftueshme për të mbuluar sigurimin e kompensimeve së bashku me shtesat për pranimin e rrezikut dhe kostot e ofruesit të sigurimit.

Mbulimi është i barabartë me një minus zbritja.

Zbritjet janë proporcion i humbjes të cilën nuk e mbulon kontrata e sigurimit. Në përgjithësi, zbritjet janë vendosur për ta zvogëluar rrezikun moral. **Rreziku moral** ndodh kur blerësit e sigurimeve rrisin sjelljen me



rrezik thjesht sepse kanë blerë sigurim kundër humbjeve.

Kompensimet janë pagesat që ia bën ofruesi i sigurimit blerësit të sigurimit për të kompensuar humbjet që tejkalojnë zbritjet e paracaktuara për shkak të rreziqeve të siguruara.

Këto koncepte janë të rëndësishme për shumicën e situatave të sigurimit të pronës, por sigurimi bujqësor kërkon definicione të tjera shtesë. Për shembull, produktet e sigurimit për **një rrezik** përfaqësojnë sigurimin e blerë kundër një rreziku specifik. Ofrimi i sigurimit nga breshëri është një shembull i një produkti për një rrezik. Blerësi i sigurimit nga breshëri merr kompensim nëse breshëri shkakton humbje të kulturave bujqësore që e tejkalon një zbritje të përcaktuar.

Megjithatë, nëse humbja e kulturave bujqësore shkaktohet nga një ndodhi pa breshër, siç është thatësia, atëherë nuk paguhet kompensimi. Nga ana tjetër, **produktet me shumë rreziqe** sigurojnë kompensimin për humbjet e shkaktuara nga pothuajse çdo rrezik tjetër përveç rreziqeve të përjashtuara në mënyrë specifike.

Rreziqet e sigurueshme janë ato që u mundësojnë siguruesve të kryejnë vlerësime aktuariale, të marrin vëllim të mjaftueshëm të aktivitetit të sigurimeve dhe t'i monitorojnë rezultatet. Rreziqet që nuk mund të sigurohen zakonisht përfshijnë:

- Zvogëlimin e rendimentit dhe të ardhurave që rezulton nga praktikat e dobëta të prodhimit (p.sh., nëse nuk ujiten apo nuk korrën);
- Mashtrimi (p.sh., raportimi si më i ulët i rendimentit aktual);
- Ndryshimet në politikën publike ose rregulloret e qeverisë.

5.2. Çështje të lidhura me zhvillimin e produkteve dhe ofrimin e tyre

Kompanitë private të sigurimeve bujqësore në përgjithësi kanë ofruar vetëm produkte për rrezik specifik për shkak se kostot e përcaktimit të humbjeve dhe pagesave të kompensimit janë shumë më të vogla se sa për rreziqet e shumëfishta. Sigurimi për një rrezik të vetëm ka tendencë ta kufizojë veprimtarinë mashtruese nga prodhuesit.

Kohët e fundit, kompanitë private kanë filluar të zhvillojnë produkte të sigurimit që bazohen në të dhëna të përafërta për kushtet e kultivimit si temperatura dhe matjet e reshjeve. Këto matje janë deri diku tërheqëse për kompanitë private, sepse prodhuesit nuk janë në gjendje të manipulojnë pragjet që përdoren që të mund të merren kompensimet.

Produktet e sigurimit nga rreziku i shumëfishtë përfshijnë kosto më të lartë për monitorimin e praktikave të prodhimit dhe aktiviteteve mashtruese. Qeveritë që dëshirojnë të ofrojnë metoda sigurie për prodhuesit bujqësorë në formën e sigurimit të kulturave bujqësore zakonisht ofrojnë subvencione të primit ose të tjera për produktet e sigurimit nga rreziku i shumëfishtë.

Një shumëllojshmëri e gjerë e produkteve të sigurimit nga rreziku i shumëfishtë, të subvencionuara, janë përgatitur dhe zbatuar në mbarë botën. Këto produkte ofrojnë nivele të ndryshme të menaxhimit të rrezikut, primeve dhe kostove të programit varësisht nga mekanizmat e përdorur për të përcaktuar rendimentet e pritshme, niveli për dhënien e kompensimit dhe vlerësimin e humbjeve.

5.2.1. Ofrimi i produktit. Shpërndarja e suksesshme e produkteve të sigurimit të kulturave bujqësore varet nga integriteti i programit, vlerësimi i saktë dhe procedurat e sigurimit, verifikimi i humbjeve, operimi efikas i biznesit, të dhënat

5.2.2. Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrje. Disa faktorë ndikojnë në pjesëmarrjen e prodhuesit në programet e sigurimit të kulturave bujqësore, duke përfshirë dizajnin e produktit, transparencën, zbatueshmërinë, normat e primit, zbritjet dhe integritetin e ofruesve të sigurimeve.

5.2.2.1. Normat e primit ndikojnë në pjesëmarrje, sepse primit e sigurimeve përfaqësojnë çmimin e blerjes së një produkti të sigurimit. Si pasojë, primit më të ulëta i nxisin prodhuesit të blejnë më shumë sigurime.

Shembull: Para vitit 2000, përafërsisht 30% e primeve të sigurimit të kulturave bujqësore janë subvencionuar nga qeveria e SHBA-ve; në atë kohë, rreth 40% e sipërfaqeve të mbjella me misër dhe grurë ishte siguruar.² Pas vitit 2000, subvencionet e SH.B.A-ve u rriten në 60% dhe përafërsisht 80% e sipërfaqes së mbjellur me misër dhe grurë ka qenë e siguruar.

5.2.2.2. Zbritjet/Mbulimi. Ashtu si shumica e produkteve të sigurimit, sigurimi i kulturave bujqësore kërkon që pjesëmarrësit të zgjedhin një zbritje. Zbritjet e sigurimit të kulturave bujqësore përfaqësojnë ndryshimin ndërmjet një rendimenti ose të ardhurave të pritura dhe rendimentit ose të ardhurave aktivizuese për pagesë kompensimi. Zbritjet janë një element i rëndësishëm i produkteve të sigurimeve sepse e zvogëlojnë rrezikun moral, që është vendimi i një individi për ta rritur sjelljen e rrezikshme thjesht për shkak se ka blerë sigurim kundër humbjeve. Zbritjet e larta zvogëlojnë rrezikun dhe ulin kostot për ofruesit e sigurimeve për shkak të zvogëlimit të rrezikut moral dhe gjasave më të vogla për kompensime.

5.2.3. Strukturat potenciale operative. Programet e sigurimit të kulturave bujqësore veprojnë brenda strukturave të ndryshme organizative, duke përfshirë agjencitë qeveritare, ofruesit e sigurimeve private, dhe kombinimet e të dyjave.

5.2.3.1. Agjencitë qeveritare. Në disa raste, agjencitë qeveritare menaxhojnë të gjitha aspektet e programeve të sigurimeve bujqësore ashtu që vendosin normat e primit, shesin dhe ofrojnë shërbime, produkte të tregut, bëjnë korrigjime të humbjeve dhe lëshojnë kompensime. Ato mbledhin dhe ruajnë të gjitha të dhënat e nevojshme për të menaxhuar dhe përmirësuar programet e sigurimit të kulturave bujqësore, përveç subvencionimit të primeve.

5.2.3.2. Kompanitë private. Disa sisteme lejojnë sektorin privat të ofrojë shumicën e produkteve të sigurimeve bujqësore. Në raste të tilla, kompanitë private përcaktojnë normat e primit, shesin dhe ofrojnë shërbime, produkte të tregut, bëjnë korrigjime të humbjeve dhe lëshojnë kompensime. Ato mbledhin dhe ruajnë të gjitha të dhënat e nevojshme për të menaxhuar dhe përmirësuar programet e sigurimit të kulturave bujqësore. Kjo veçanërisht ndodh për produktet me një rrezik të vetëm.

5.2.3.3. Sistemet e përziera janë ato në të cilat agjencitë qeveritare dhe kompanitë private ndajnë elemente operative të programit. Këto elemente mund të përfshijnë funksione të përbashkëta të menaxhimit të të dhënave (p.sh. mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave) ose lëshimin e kompensimeve.

Kompanitë private janë përgjegjëse për dorëzimin e produktit, marrin primet, paguajnë kompensimet dhe kanë pjesën më të madhe të kontaktit me prodhuesin.

Për ofertat me rreziqe të shumta, megjithatë, qeveritë shpesh janë të përfshira në ofrimin e sigurimit të kulturave bujqësore. Primet mund të subvencionohen nga qeveria nëpërmjet kompensimit të kompanive private ose t'i jepen prodhuesve bujqësorë. Madje edhe në këto sisteme, agjencitë qeveritare shpesh ofrojnë mbikëqyrje dhe rishikim të aktiviteteve të kompanive private, ofertave të produkteve, efikasitetit, barazisë pjesëmarrëse, qëndrueshmërisë financiare, parandalimit të mashtrimit dhe zgjidhjes së kontesteve. Shtetet e Bashkuara kanë një sistem të përzier.

¹ Në Shtetet e Bashkuara, pjesëmarrja matet si sipërfaqja e tokës së siguruar në krahasim me sipërfaqen totale të tokës së mbjellur me një kulturë.

Marrëdhëniet ndërmjet agjencive qeveritare dhe kompanive private në ofrimin e shërbimeve të sigurimit të kulturave bujqësore mund të jenë komplekse. Pavarësisht nga natyra e këtyre marrëdhënieve, përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë duhet të përcaktohen qartë. Përveç kësaj, të gjitha sistemet duhet të jenë transparente në aspektin e rrjedhës së fondeve dhe zgjidhjes së kontesteve. Vendimmarrja dhe llogaridhënia duhet të përcaktohen qartë.

5.3. Llojet e produkteve të sigurimit

Një diapazon i gjerë i produkteve të sigurimit të kulturave bujqësore janë krijuar dhe zbatuar. Në përgjithësi, produktet e sigurimit mund të ndahen në produkte individuale, të bazuara në zonë dhe produkte të përafërta.

5.3.1. Produktet e sigurimeve individuale janë ato për të cilat aktivizuesi i kompensimit dhe primet janë specifike për historitë e rendimentit dhe rezultatet e prodhimit për çdo fermë individuale.

5.3.1.1. Produktet e sigurimeve individuale në bazë të rendimentit mbështeten në të dhënat historike të prodhimit nga fermat individuale për të përcaktuar rendimentet e pritshme. Kompensimet aktivizohen kur rendimentet e fermave individuale bien nën një pikë të caktuar, e cila bazohet në përzgjedhjen e mbulimit individual të prodhuesve. Kompensimet bazohen në dallimin ndërmjet rendimentit aktual dhe aktivizuesit të kompensimit dhe vlerësohen me një çmim të paracaktuar për mallin siç është specifikuar kur është lidhur kontrata e sigurimit.

5.3.1.2. Produktet e sigurimeve individuale në bazë të të hyrave janë të ngjashme me produktet në bazë të rendimentit sepse përdorin të dhëna individuale historike të prodhimit të fermave për t'i përcaktuar rendimentet e pritura. Përveç kësaj, çmimet e pritshme të të korrave përcaktohen kur blihet kontrata e sigurimit. Prodhuesit zgjedhin një nivel të mbulimit bazuar në të ardhurat e pritura për sipërfaqe (domethënë, produkti i rendimentit të pritur me çmimin e pritur të të korrave). Kompensimi paguhet me rastin e të korrave, nëse të ardhurat për hektar bien nën aktivizuesin e kompensimit pavarësisht nëse shkaku i humbjes është çmimi më i ulët, rendimenti më i ulët ose një kombinim i të dyjave. Në disa raste ekzistojnë mundësi që lejojnë që niveli i të hyrave që aktivizon kompensimin të rritet nëse çmimet e mallrave rriten ndërmjet lidhjes së kontratës së sigurimit dhe korrjes.

5.3.2. Produktet e indeksit të përafërt. Ndryshe nga produktet individuale, aktivizuesit e kompensimit me indeksin e përafërt dhe primet përcaktohen sipas zonës ose historisë së rajonit dhe rezultateve të prodhimit.

Produktet e sigurimit sipas rendimentit në bazë të sipërfaqes janë një variacion i produkteve të sigurimit të rendimentit individual. Dallimi kryesor është mekanizmi i përdorur për ta përcaktuar rendimentin e pritshëm dhe rendimentin aktual. Produktet e sigurimit sipas rendimentit në bazë të sipërfaqes përdorin të dhëna nga një rajon (p.sh., një qark ose krahinë) për të përcaktuar rendimentet e pritshme dhe nivelin e aktivizimit të kompensimit. Prodhuesit të cilët kanë lidhur kontratat e sigurimeve kompensohen sa herë që rendimentet rajonale bien nën një përzgjedhje të mbulimit të prodhuesve të rendimenteve të pritura rajonale. Një përparësi e këtij lloji të produktit është se nuk kërkon të dhëna për prodhimin historik ose aktual të një ferme specifike, por informacion në lidhje me sipërfaqet, përshkrimet ligjore dhe kulturat bujqësore të siguruara.

Një nga mangësitë e këtij lloji të sigurimit është se prodhimi i një ferme individuale mund të mos jetë i afërt me prodhimin rajonal. Një prodhues mund të ketë rendiment mbi mesataren në një vit në të cilin rendimentet rajonale kanë qenë të ulëta (ose anasjelltas), duke lejuar që prodhuesi të marrë kompensim.

Anasjelltas, një prodhues i vetëm mund të korrë më pak se rendimentet mesatare në një vit për të cilin rendimentet rajonale kanë qenë mbi mesataren; ky prodhues nuk do të marrë kompensim edhe pse prodhimi i tij ka qenë nën mesataren. Për këtë arsye, sigurimi i rendimenteve në bazë të zonës në përgjithësi ofron mbrojtje më pak se produktet e sigurimit individual të rendimentit. Megjithatë, kostot e vlerësimit dhe monitorimit janë shumë më të ulëta në krahasim me produktet individuale të sigurimit të bazuar në rendiment.

Produktet e sigurimit sipas të hyrave në bazë të sipërfaqes janë një variant i produkteve të sigurimit të të hyrave individuale. Produktet e sigurimit sipas të hyrave në bazë të sipërfaqes kombinojnë procesin e përdorur për të përcaktuar rendimentin e pritshëm në produktet e sigurimit të rendimenteve në bazë të zonës me ato që përdoren për të përcaktuar çmimet e pritshme të të korrave në produktet e sigurimit individual të bazuar në të hyra. Kompensimet bazohen në rezultatet e të hyrave sipas zonës.

5.3.2.1. Produktet e tjera sipas indeksit përdorin tregues të ndryshëm të përafërt për kushtet e kultivimit për të aktivizuar pagesat e kompensimit. Deri më tani janë zhvilluar dy produkte të indeksit të **motit**. E para përdor reshjet dhe/ose temperaturën si një vlerë e përafërt për kushtet e kultivimit brenda një rajoni. Produkti i dytë përdor masat e rritjes vegetative si bazë për pagesat e kompensimit. Ky produkt përdor imazhet satelitore për të aktivizuar pagesat e kompensimit.

Produktet e indeksit të përafërt kanë përparësi mbi produktet sipas zonës, sepse rajonet mund të përcaktohen më ngushtë. Këto produkte gjithashtu kanë përparësi ndaj produkteve individuale sepse prodhuesit individualë nuk kanë stimulim për të ndikuar në rendimentin aktual ose aftësinë për t'i manipuluar aktivizuesit e kompensimit.

5.4. Palët e interesuara

Prodhuesit, ofruesit e sigurimeve, agjencitë qeveritare dhe risiguruesit janë të gjitha palë të interesuara në ofrimin e produkteve të sigurimit të kulturave bujqësore. Çdo grup i palëve të interesuara ka objektiva të ndryshme dhe ndërtimi i besimit në një program kërkon që të gjithë pjesëmarrësit t'i kuptojnë këto qëllime konkurruese.

5.4.1. Prodhuesit. Prodhuesit janë të interesuar ta ulin rrezikun, të rrisin fitimet dhe ta përmirësojnë qasjen në kredi. Për shkak të kompleksitetit dhe detajeve të shumta që lidhen me produktet e sigurimit të kulturave bujqësore, qëllimi primar i sigurimit të kulturave bujqësore - për t'u dhënë prodhuesve bujqësorë produkte të sigurimit që u ndihmojnë ta menaxhojnë rrezikun - anashkalohet shpesh. Mosarritja për t'u përqendruar në nevojat e konsumatorëve shpesh ka si rezultat përqindje të paktë të pjesëmarrjes, që mund ta përkeqësojë përzgjedhjen e pafavorshme, të rrisë normat e primit dhe ta ulë profitabilitetin.

5.4.2. Siguruesit primarë. Agjencia lëshuese (ose siguruasi primar) është subjekti që shet kontratat e sigurimit të prodhuesit dhe në shumë sisteme ka pjesën më të madhe të realizimit të kontratës. Agjencia lëshuese mund të jetë ose kompani private ose njësi qeveritare. Agjencitë lëshuese ofrojnë shërbimet e shitjeve, arkëtimin të primeve, korrigjimin e humbjeve dhe shërbimet e pagesës së kompensimit, si dhe shërbimet e nevojshme përkrahëse. Është interesante që agjencitë lëshuese kanë tendencë ta mbajnë sasinë më të vogël të rrezikut të programit të përgjithshëm të sigurimeve. Shumica e agjencive lëshuese nuk kanë rezerva të mjaftueshme financiare për të pranuar më shumë se një shumë minimale të rrezikut të sigurimit; pjesa tjetër e rrezikut në përgjithësi ndahet me risiguruesit ose qeveritë.

5.4.3. Risiguruesit. Nëse qeveritë nuk i ofrojnë të gjitha shërbimet e sigurimit, risiguruesit janë një element kritik në zhvillimin e programeve të suksesshme të sigurimit të kulturave bujqësore. Risiguruesit e pranojnë pjesën më të madhe të rrezikut të krijuar në fillim nga agjencitë lëshuese. Rrjedhimisht, risiguruesit

ofrojnë pjesën më të madhe të pagesave të kompensimit. Dizajnesit e sigurimit të kulturave bujqësore duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojat, qëllimet dhe procedurat e risigurimit.

5.4.4. Qeveria. Qeveritë luajnë shumë role në programet e sigurimit të kulturave bujqësore. Ato mund të krijojnë dhe ofrojnë produkte të sigurimit të kulturave bujqësore, risigurime, 'ndalim të humbjeve' ose të shërbejnë si rregullatorë. Në aspektin e rregullimit, agjencitë qeveritare shpesh e mbikëqyrin integritetin financiar të agjencive lëshuese dhe risiguruesve. Aktiviteti rregullativ është veçanërisht i rëndësishëm për ta konfirmuar se agjencitë lëshuese kanë rezerva të mjaftueshme të parasë për të mbuluar pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe se përgjegjësia e mbetur është përgjegjësi e risiguruesve me rezerva të mjaftueshme financiare.

Agjencitë qeveritare gjithashtu i zbatojnë politikat e subvencionimit të qeverisë dhe i auditojnë agjencitë lëshuese. Agjencitë qeveritare shpesh transferojnë fonde tek kompanitë private të sigurimit për t'i kompensuar shpenzimet administrative ose për të dhënë pagesa të subvencioneve. Qeveritë shpesh e konfirmojnë nëse agjencitë lëshuese janë duke i ngarkuar prodhuesit me norma të primeve që aktuarisht janë të arsyeshme, neto nga subvencionet. Agjencitë qeveritare janë të përfshira në zbatimin e kontratave nëpërmjet sistemeve gjyqësore ose ndërmjetësimit, edhe duke siguruar që pagesat e kompensimeve të bëhen në përputhje me kontratën e sigurimit

5.5. Proceset dhe procedurat

Programet e suksesshme të sigurimit të kulturave bujqësore kërkojnë disa procese dhe procedura, duke përfshirë regjistrimin, verifikimin, pagesat e primit, korrjgimin e humbjeve, pagesat e kompensimeve dhe njoftimet ndërmjet risiguruesve dhe rregullatorëve qeveritarë.

5.5.1. Regjistrimi. Programet e sigurimit të kulturave bujqësore përfshijnë shumë veprime. Edhe pse shumë prej tyre duken të qarta, secili veprim është i rëndësishëm për zhvillimin e një programi të suksesshëm të sigurimit të kulturave bujqësore.

Para se prodhuesit të nënshkruajnë (blejnë) kontratën e sigurimit të kulturave bujqësore, është e nevojshme të rishikohen performanca dhe problemet e programit të mëparshëm. Duhet të ketë mekanizma për të mundësuar që problemet dhe kërkesat e prodhuesve të regjistrohen dhe kategorizohen. Nëse këto probleme/shqetësime janë legjitime dhe të duhura, atëherë programi duhet të modifikohet sipas tyre. Para regjistrimit:

- Modifikohen detajet e programit, duke përfshirë normat e primit nëse është e nevojshme;
- Rishikohen të dhënat dhe sistemet e operacioneve të tjera;
- Trajtohen personeli i shitjes;
- Përgatitet përkrhja e programit dhe mblidhen materiale informative. Duhet të jenë procedurat e përshkruara për menaxhimin e situatave të zakonshme dhe informatat duhet t'u jepen prodhuesve. Prodhuesit duhet t'i kuptojnë shërbimet që u ofrohen në këmbim të pagesave të primit që i bëjnë ata;
- Shqyrtohen strategjitë dhe marrëveshjet e bartjes së rrezikut duke përfshirë shpërndarjen e rrezikut dhe përgjegjësitë e kompanive primare të sigurimit, risiguruesve dhe qeverive;
- Finalizohen detajet e polisës së sigurimit para periudhës së regjistrimit.

Gjatë periudhës së regjistrimit të kontratës, është e nevojshme që:

- Të konfirmohet që prodhuesit e kuptojnë programin përfshirë llogaritjet e primit;
- Të regjistrohet çka kanë zgjedhur prodhuesit;
- Të llogariten primit;
- Të regjistrohet informacioni i prodhuesit (p.sh., emri, adresa);
- Të regjistrohet informacioni i prodhimit (p.sh., kulturat, sipërfaqja, verifikimi);
- Të nënshkruhen marrëveshjet e sigurimit dhe u jepen të dy palëve kopjet;
- Mblidhen komentet, brengat dhe rekomandimet e prodhuesit.

Pas periudhës së regjistrimit të kontratës, është e nevojshme që:

- Të shënohet informacioni i regjistrimit në një bazë të dhënash. Duhet të ekzistojë një metodë elektronike për futjen e këtij informacioni gjatë kohës kur nënshkruhen kontratat. Një metodë është të futen informatat nga distanca direkt në një bazë të dhënash elektronike, por kjo qasje është problematike nëse ka probleme për bartjen e informatave elektronike. Prandaj, nganjëherë është e preferueshme të futen këto të dhëna pas periudhës së regjistrimit për të mundësuar



korrigjimet nëse është ndërprerë transmetimi;

- T'u jepen informacione të tjera bartësve të rrezikut (sa hektarë janë siguruar, përgjegjësia, cilat kultura bujqësore);
- Të plotësohen kërkesat rregullative, veçanërisht për raportim;
- Të vendosen marrëveshjet e nënshkruara në një sistem dosjesh;
- Të regjistrohen komentet dhe rekomandimet e prodhuesve;
- Të sigurohet që të dhënat ruhen në disa vende rezervë;
- Të njoftohen prodhuesit për datën përfundimtare për modifikimin e kontratës (modifikimet e kontratës mund të përfshijnë korrigjimin e sipërfaqes menjëherë para mbjelljes, por pas nënshkrimit të kontratës së sigurimit);
- Futen modifikimet e prodhuesit në një bazë të dhënash;
- Njoftohen bartësit e tjerë të rrezikut me informacionin e kërkuar;
- Plotësohen kërkesat rregullative;
- Kryhet dhe regjistrohet ndonjë inspektim i kërkuar.

5.5.2. Pagesat e primit. Në shumicën e rasteve, prodhuesit paguajnë primet e sigurimit kur blihet kontrata. Shtetet e Bashkuara i mundësojnë prodhuesit të shtyjë pagesat e primit për më vonë gjatë vitit. Megjithatë, Shtetet e Bashkuara kanë pajtueshmëri për pagesën e primeve me shumë programe të tjera qeveritare, gjë që ul në minimum moskryerjen e pagesave. Për t'i marrë pagesat e primit është e nevojshme:

- Të vërtetohet saktësia e primeve të cituara gjatë regjistrimit. Kontratat duhet t'i specifikojnë procedurat që duhen ndjekur nëse prodhuesit nuk japin pagesa të mjaftueshme të primeve;
- Të njoftohen prodhuesit për shumat e primit dhe të jepen faturat;
- Të arkëtohen pagesat e primit;
- Regjistrohet pagesa ose mos-pagesa;
- Njoftohen prodhuesit për pranimin e pagesës;
- Njoftohen prodhuesit për anulimin e polisës nëse nuk janë pranuar pagesat e primit;
- Njoftohen rregullatorët dhe bartësit e tjerë të rrezikut sipas nevojës.

5.5.3. Korrigjimi i humbjeve quhet procesi i verifikimit se rendimentet aktuale të të korrave janë nën nivelin aktivizues të rendimentit për kompensim. Ky është një nga faktorët më kritikë në krijimin e një programi të suksesshëm të sigurimit të kulturave bujqësore. Palët e interesuara duhet:

- Të rishikojnë procedurat e korrigjimit të humbjeve, operacionet, infrastrukturën dhe personelin;
- T'i informojnë prodhuesit për procedurat e njoftimit të humbjeve;
- Ta sigurojnë një mekanizëm për të pranuar kërkesat e prodhuesve për korrigjimin e humbjeve;
- Të përcaktojnë dhe zbatojnë inspektimet në terren nëse kërkohet;
- Të rregullojnë, dokumentojnë dhe regjistrojnë humbjat;
- T'i informojnë prodhuesit për vlerësimet paraprake të pagesës së kompensimit.



5.5.4. Pagesa e kompensimit. Kur rendimentet aktuale (ose të ardhurat) janë nën nivelin aktivizues për kompensim, krijohet borxhi i pagesës së kompensimit. Shuma e pagesës së kompensimit përcaktohet nga diferenca ndërmjet rendimenteve aktuale (ose të ardhurave) dhe nivelit të kompensimit të shumëzuar me çmimin me të cilin vlerësohet malli. Duhet të ndiqen disa procedura për shpërndarjen e pagesave të kompensimit:

- Rishikohen, dokumentohen dhe regjistrohen llogaritjet e kompensimeve bazuar në korrigjimet e humbjeve;
- Paguhet kompensimet për prodhuesit;
- Njoftohen dhe faturohen partnerët me rrezik;
- Arkëtohen pagesat nga partnerët që bartin rrezik;
- Regjistrohen pagesat nga partnerët që bartin rrezik në bazën e të dhënave;
- Regjistrohet pagesa e kompensimit të prodhuesit në bazën e të dhënave

5.5.5. Veprimet finale. Një sërë procedurash duhet të ndiqen çdo vit për përfundimin e suksesshëm të ciklit të sigurimit të kulturave bujqësore.

- Plotësohen kërkesat rregullative;
- Analizohet performanca e programit;
- Përgatiten raportet e duhura;
- Përgatitjet për vitin e ardhshëm.

5.6. Shembull

Termet e mëposhtëm përdoren për të ilustruar një shembull të thjeshtë të sigurimit të kulturave bujqësore:

- **Rendimenti i pritshëm:** Rendimenti mesatar historik i një prodhuesi;
- **Çmimi:** Çmimi për njësi të prodhimit i përdorur për llogaritjen e primeve dhe pagesës së kompensimit;
- **Zbritja:** Një përqindje të humbjes e absorbon prodhuesi para se të kualifikohet për pagesë të kompensimit.

- **Mbulimi:** Pjesa e kulturave bujqësore që sigurohet:

$$Mbulimi = 1 - Zbritja$$

- **Aktivizuesi i kompensimit:** Niveli i rendimentit që aktivizon pagesë të kompensimit:

$$Rendimenti aktivizues = Rendimenti i pritur x Mbulimi$$

- **Detyrimi:** Pagesa maksimale e kompensimit:

$$Detyrimi = Rendimenti aktivizues x Çmimi$$

- **Norma e primit e rrezikut të pastër:** Pagesat e pritura të kompensimit si përqindje e detyrimit.
- **Norma e ngarkuar:** Kostoja e ofrimit të sigurimit mbi normën e primit të rrezikut të pastër:
- **Norma totale e primit:**

$$Norma\ totale\ e\ primit = Norma\ e\ ngarkuar + Norma\ e\ primit\ e\ rrezikut\ të\ pastër$$

- **Primi total:** Kostoja totale e sigurimit:

$$Primi\ total = detyrimi\ x\ norma\ totale\ e\ primit$$

- **Primi i prodhuesit:** Kostoja e sigurimit të prodhuesit:

$$Primi\ i\ prodhuesit = (1 - norma\ e\ subvencionit) x (Primi\ total)$$

- **Norma e subvencionit:** Pjesa e primit total që paguhet nga qeveria;
- **Kompensimi:** Kompensimi për rendimentin para aktivizuesit të kompensimit.

Shembull: Supozoni që një blerës blen një produkt sigurimi individual në bazë të rendimentit me këto attribute:

$$Zbritja = 40\%$$

$$Norma\ e\ primit\ e\ rrezikut\ të\ pastër = 0.87\%$$

$$Norma\ e\ ngarkuar = 3\%$$

$$Norma\ e\ subvencionit = 25\%$$

$$Çmimi\ i\ prodhimit\ (gruri) = 1.0$$

1 hektar janë siguruar

Detyrimi bazohet në rendimentin e pritur. Supozoni që prodhuesi ka këtë histori të prodhimit:

Viti	Rendimenti historik (ton për hektar)
1	2.7
2	3.6
3	2.4
4	3.3

Në këtë rast, rendimenti i pritur (ose mesatar) = 3.0 ton/ha

Rendimentet e pritura janë të ndjeshme ndaj madhësisë së mostrës. Shumë shtete përdorin madje edhe vetëm katër vjet të dhëna, ndërsa të tjerat përdorin më shumë se dhjetë vjet ose më shumë për të llogaritur rendimentet e pritura. Më pak vite të të dhënave mund të kenë observime ekstreme. Kur përdoren mostrat më të gjata, mund të jetë e rëndësishme të merret parasysh trendi i rendimentit që vjen nga ndryshimet teknologjike. Në shembullin tonë:

$$29 \quad \text{Detyrimi} = (\text{Rendimenti i pritur}) \times (\text{mbulimi}) \times (\text{\pounds mimi}) \times (\text{sipërfaqja}) = (3 \text{ ton / ha}) \times (1 - 0.4) \times (\$1 / \text{ton}) \times (1.0 \text{ ha}) = \$1.80$$

$$\text{Norma totale e primit} = (\text{norma e ngarkuar} + \text{norma e primit e rrezikut të pastër}) = (3\% + 6\%) = 9\%$$

$$\text{Primi total} = (\text{detyrimi} \times \text{norma totale e primit}) = (\$1.80) \times (0.09) = \$0.162$$

$$\text{Subvencioni} = (\text{norma e subvencionit}) \times (\text{primi total}) = (0.25) \times (\$0.162) = \$0.0405$$

$$\text{Primi i prodhuesit} = (1 - \text{norma e subvencionit}) \times (\text{primi total}) = (0.75) \times (\$0.162) = \$0.1215$$

$$\text{Rendimenti aktivizues} = (\text{mbulimi}) \times (\text{rendimenti i pritur}) = (1 - 0.4) \times (3 \text{ ton/ha}) = 1.8 \text{ ton/ha}$$

Nëse rendimenti aktual është më i madh se aktivizuesi i kompensimit, nuk paguhet kompensimi. Në shembullin tonë, nëse rendimenti aktual është 2.0 ton/ ha, atëherë nuk krijohet kompensimi. Mirëpo, nëse rendimenti aktual është më pak sesa aktivizuesi i kompensimit, atëherë duhet të paguhet kompensimi. Supozoni që rendimenti aktual i të korrave është 1 ton për hektar. Atëherë, pagesa e kompensimit llogaritet si:

$$\text{Kompensimi} = (\text{Rendimenti aktivizues} - \text{Rendimenti aktual}) \times (\text{\pounds mimi}) \times (\text{Sipërfaqja}) = (1.8 \text{ ton/ha} - 1 \text{ ton/ha}) \times (\$1/\text{ton}) \times (1.0 \text{ ha}) = \$0.80$$

Pjesa 2: Konceptet themelore

6.0. Metodatat aktuariale

Metodat aktuariale janë proceset me të cilat përcaktohen primet e sigurimit ose normat e sigurimit. Këto prime duhet të jenë të mjaftueshme për t'i kompensuar siguruesit dhe risiguruesit për kompensimet e pritura, kostot e ofrimit të shërbimeve të sigurimit, rrezikun afarist, dhe profitin.

Supozoni që prodhuesi është i interesuar për blerjen e një produkti të sigurimit të rendimentit me këto karakteristika:

Sipërfaqja = 1 hektar

Çmimi = 1 UAH për ton

Zbritja = 40%

Gjithashtu, prodhuesi ka këtë histori të rendimentit, për të cilën aktivizuesi i kompensimit dhe pagesat janë:

Tabela 1. Shembull i thjeshtë i vlerësimit për sigurimin

Viti	Rezultati i rendimentit	Aktivizuesi i kompensimit	Pagesa e kompensimit
1	2.70	1.8	0.00
2	1.72	1.8	0.08
3	3.24	1.8	0.00
4	4.28	1.8	0.00
5	4.20	1.8	0.00
6	4.73	1.8	0.00
7	0.32	1.8	1.48
8	2.77	1.8	0.00
9	4.10	1.8	0.00
10	1.92	1.8	0.00

Kjo ka si rezultat:

Rendimenti i pritur = *Rendimenti mesatar* = 3

dhe

Mbulimi = $(1 - \text{zbritja}) = 60\%$

6.1. Norma e rrezikut të pastër

Detyrimi përfaqëson pagesën maksimale të mundshme të kompensimit në një vit të dhënë. Në këtë rast, detyrimi llogaritet si:

Detyrimi = *Aktivizuesi i kompensimit* × *Çmimi*

Duke pasur parasysh që çmimi = 1.0,



Norma e pastër e rrezikut llogaritet si koeficienti i pagesës së kompensimit të pritur dhe detyrimit:

$$Norma = \frac{Pagesa\ e\ kompensimit\ të\ pritur}{Detyrimi} = \frac{0.156}{1.8} = 0.087$$

Rreziku i pastër

Duhet të theksohet se ky shembull është paraqitur vetëm për ilustrim. Dhjetë observime janë të pamjaftueshme për llogaritjen e normave të rrezikut të pastër. Në rastet e mostrave të vogla, duhet të përdoren metoda të tjera për t'i përcaktuar shkallët e rrezikut të pastër, duke përfshirë gjykimet nga ekspertët, të dhënat eksperimentale dhe krahasimet me kulturat bujqësore dhe rajonet e tjera.

6.2. Ngarkesat dhe normat totale të primit.

Ngarkesat janë shtesa ndaj normave të rrezikut të pastër që i kompensojnë siguruesit për kostot dhe rreziqet shtesë. Rrjedhimisht, ngarkesat janë specifike për produktin, sepse rreziku më i lartë mund të shoqërohet me kultura bujqësore të ndryshme ose madje edhe prodhues të ndryshëm. Mallrat që janë shumë sezonale, kanë pjesë të vogël të tregut, kanë të dhëna të pakta historike ose tregtohen rrallë, shpesh kërkojnë ngarkesë të lartë. Ngarkesat zakonisht përfshihen në prime për të kompensuar:

- **Konfidencën e vlerësimit.** Ngarkesat rriten për produktet e sigurimeve që janë vlerësuar me të dhëna të dobëta ose me metodologji të dyshimta;
- **Shërbimin e sigurimit.** Ngarkesat janë më të mëdha për produktet që kërkojnë kosto më të lartë të monitorimit, rishikime të shpeshta, auditime dhe tregje të vogla sigurimi;
- **Rreziqet politike, gjyqësore dhe të tjera.** Ngarkesat janë më të mëdha në rajonet ku të drejtat e pronës të qarta dhe të zbatueshme janë më problematike;
- **Ndryshimin strukturor.** Ngarkesat janë më të mëdha për produktet dhe mallrat që i nënshtrohen ndryshimeve politike ose teknologjike.



Ngarkesat janë nganjëherë funksion i vlerësimeve të kostos që bazohen në shërbimin e kontratës dhe performancën historike të produkteve të sigurimeve të tjera. Megjithatë, ngarkesat shpesh kanë si rezultat gjykime subjektive të atyre që janë të përfshirë në vlerësimin aktuarial.

Ngarkesat mund të llogariten në normat e primit ose si proporcion i një norme të primit ose si shtesë fikse në normë të primit:

Ngarkesat proporcionale i shtohen normës së rrezikut të pastër si:

$Norma\ totale = (Norma\ e\ rrezikut\ të\ pastër) \times (1 + Ngarkesa)$

Ngarkesat fikse shtesë llogariten si: $Norma\ totale = (Norma\ e\ rrezikut\ të\ pastër) + (Norma\ e\ ngarkesës)$

6.3. Metodatat e vlerësimit

Disa metoda formale përdoren për të vlerësuar produktet e sigurimit të kulturave bujqësore, duke përfshirë metodat empirike, parametrike, të kombinuara dhe hapësinore. Në përgjithësi, sasia dhe cilësia e të dhënave historike diktojnë zgjedhjen e metodës së vlerësimit.

6.3.1. Metodatat empirike të vlerësimit përdorin të dhëna historike për llogaritjen e primeve. Shembulli i mësipërm ka përdorur një metodë empirike të vlerësimit.

6.3.2. Metodatat parametrike të vlerësimit përdorin distribucionet specifike të probabilitetit dhe jo distribucionet empirike (të dhënat aktuale) për të vendosur normat e primeve. Metodatat parametrike të vlerësimit përdoren shpesh në rastet kur të dhënat historike nuk janë të sasisë ose cilësisë së mjaftueshme për të mundësuar përdorimin e metodave empirike të vlerësimit. Distribucionet më të shpeshtë të probabilitetit të përdorur për të vlerësuar produktet e sigurimit janë distribucionet normale, distribucionet uniforme dhe distribucionet e vlerës ekstreme.

6.3.3. Metoda e kombinuar. Metodatat empirike dhe parametrike të vlerësimit shpesh kombinohen për të zhvilluar normat e primit kur ka të dhëna në dispozicion.

Pas përdorimit të secilës metodë, krahasohen dy rezultatet e normave. Nëse të dyja metodat gjenerojnë rezultate të ngjashme, atëherë siguresit mund të jenë arsyeshëm të sigurtë për procedurat e vlerësimit. Distribucioni uniform mund të përdoret për të zhvilluar një normë të sipërme mbi normat e primit.

6.3.4. Metodatat e vlerësimit me të dhëna të kufizuara "në



lokacion". Të dhënat historike shpesh janë të kufizuara, kështu që mund të përdoren shumë metoda të tjera për të vendosur normat e primit. Këto norma zakonisht përfshijnë ngarkesa relativisht të larta. Këto metoda përfshijnë 'nivelizimin special', normat nga kulturat biologjikisht të ngjashme, normat nga rajonet me kushte të ngjashme të kultivimit, përdorimi i metodave parametrike konservatore dhe mendimi subjektiv i ekspertëve të sigurimit të kulturave.

Në përgjithësi, bëhet e vështirë dhe kushton shtrenjtë të risigurohen rreziqet nëse nuk ka të dhëna të cilësisë së lartë.

7.0. Menaxhimi i të dhënave dhe kontabiliteti

Mbledhja e të dhënave, analiza dhe menaxhimi janë thelbësore për suksesin e çdo programi të sigurimit. Të dhënat përdoren për të vlerësuar produktet, për ta risiguruar rrezikun, për të zbuluar aktivitete mashtruese, për të përshtatur politikat publike dhe për ta matur suksesin. Rreziku moral dhe përzgjedhja e pafavorshme në produktet e sigurimit të kulturave bujqësore me shumë rreziqe e bëjnë edhe më të rëndësishëm menaxhimin e të dhënave.

7.1. Nevojat për të dhëna

Të dhënat dhe përpjekjet arsimore kërkohen nga:

- Fermerët dhe organizatat bujqësore;
- Ofruesit privatë të sigurimit primar;
- Kompanitë e risigurimit;
- Agjencitë qeveritare që menaxhojnë dhe/ose operojnë programet e sigurimit të kulturave;
- Agjencitë rregullative dhe/ose bordet mbikëqyrëse;
- Hartuesit e politikave.

7.1.1. Prodhuesit. Bujqit dhe organizatat bujqësore kanë nevojë për të dhëna dhe informacione për:

- Të vendosur nëse duan ose kanë nevojë për produkte të sigurimeve bujqësore;
- Të përzgjedhur se cilat produkte duhet t'i përdorin, nivelet e mbulimit dhe zbritjet;
- Të përcaktuar të drejtën dhe madhësinë e pagesave të kompensimit;
- Të arritur afatet e regjistrimit dhe për t'iu përgjigjur kërkesave për korrigjimin e humbjeve;
- Të vlerësuar performancën e produkteve të sigurimit me kalimin e kohës dhe për të vlerësuar nëse ato sigurojnë mbrojtje të mjaftueshme nga rreziku.

7.1.2. Ofruesit **Primarë** të sigurimeve kanë nevojë për të dhëna për:

- Shërbimin e produkteve;
- Vendosjen e normave të primit;
- Pagesën e kompensimeve;
- Vendosjen e standardeve të performancës dhe monitorimin e performancës;
- Monitorimin e humbjeve individuale të fermave për të identifikuar mashtrimet dhe prodhuesit me rrezik të lartë;
- Kryerjen e kërkimeve, krijimin e produkteve të reja dhe modifikimin e produkteve ekzistuese;
- Dhënien e informatave të produkteve dhe atyre financiare për



auditimet e brendshme dhe të jashtme;

- Marrjen e rimbursimeve nga qeveria për kostot e shërbimit dhe subvencionet e primeve;
- Përmbushjen e kërkesave të informacionit dhe të standardeve të performancës së kompanive të risigurimit;
- Zgjidhjen e kontesteve.

7.1.3. Kompanitë e **risigurimit** kanë nevojë për të dhëna për:

- Vlerësimin e rrezikut të portfoliove të sigurimeve bujqësore;
- Vendosjen e normave të primit të risigurimit;
- Shërbimin e kontratave të risigurimit.

7.1.4. Agjencitë **qeveritare** kanë nevojë për të dhëna për:

- Shërbimin dhe funksionimin e programeve;
- Rregullimin e agjencive lëshuese dhe risiguresve;
- Kërkimin, zhvillimin dhe përmirësimin e produkteve;
- Vendosjen e standardeve të performancës së produkteve;
- Vlerësimin e performancës së produktit kundrejt standardeve;
- Plotësimin e kërkesave për të dhëna për auditimet e brendshme dhe të jashtme;
- Llogaritjen dhe pagesën e subvencioneve të primit dhe shërbimeve;
- Zgjidhjen e kontesteve dhe menaxhimin e procedurave të zgjidhjes së kontesteve.

7.1.5. **Agjencitë rregullative dhe Bordet Mbikëqyrëse** kanë nevojë për informata për:

- Vendosjen e standardeve për performancën e programeve dhe produkteve;
- Vlerësimin e performancës së programeve dhe produkteve;
- Vlerësimin e procedurave të zgjidhjes së kontesteve;
- Vlerësimin e produkteve të propozuara të reja dhe ndryshimet në produktet ekzistuese;
- Ofrimin e informatave për performancën e programit për politikëbërësit.

7.1.6. **Politikë bërësit** kanë nevojë për të dhëna dhe informata për:

- Vendosjen e kriterëve të performancës për pjesëmarrjen në program në mesin e bujqve dhe për shpenzimet buxhetore;
- Vlerësimin e performancës së programit;
- Përcaktimin dhe monitorimin e niveleve të financimit të subvencioneve dhe shpenzimet buxhetore përkatëse.

7.2. Mbledhja e të dhënave

Të dhënat duhet të mblidhen nga disa subjekte duke përfshirë fermat, ofruesit e sigurimeve primare dhe palët e treta private dhe publike.

7.2.1. Niveli i fermës. Produktet e sigurimit individual të rendimenteve dhe të ardhurave kërkojnë shumë të dhëna duke përfshirë:

- Kulturat e prodhuara, zonat e mbjella me kulturat specifike, praktikat e prodhimit të bimëve, lokacionet e arave dhe historitë e rendimentit;
- Lokacionet e fermave, emrat e fermerëve të siguruar ose pronarëve të tokës, dhe kodet e identifikimit të fermave ose bujqve;
- Mundësitë për zgjedhje të produkteve të sigurimit, duke përfshirë nivelet e mbulimit, mundësitë e çmimeve, zbritjet, mundësitë e bashkëpagesave, opsionet e ri-mbjelljes, shtytësit e

cilësisë dhe mundësitë e ndalimit të mbjelljes.

7.2.2. Ofruesit e sigurimeve primare duhet të mbledhin dhe menaxhojnë të dhënat për:

- Pjesëmarrje në program dhe produkt (p.sh., numri i kontratave sipas produktit, programit, rajonit, sipërfaqes së mbuluar, përgjegjësisë totale, niveleve të mbulimit dhe përzgjedhjeve të çmimeve);
- Normat e primit dhe të ardhurat;
- Rendimentet e vitit aktual sipas fermës, programit, produktit dhe rajonit;
- Pagesat e kompensimeve sipas produktit dhe rajonit;
- Rrezikun e mbetur dhe rrezikun e risiguruar;
- Të ardhurat e mbajtura;
- Suficitin e llogarive;
- Shpenzimet e shërbimit të produkteve dhe programeve.

7.2.3. Palët e treta private dhe publike. Agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare, universitetet, institutet kërkimore dhe kompanitë e tjera private mbledhin të dhëna. Prodhuesit dhe ofruesit e sigurimeve shpesh kanë qasje në të dhënat e palëve të treta që mund të jenë mbledhur për arsye që nuk është sigurimi i kulturave bujqësore. Në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar, agjencitë qeveritare mbledhin të dhëna për:

- Të dhënat e prodhimit historik sipas qarkut dhe rajonit (shpesh të nevojshme për vendosjen e normave të primit dhe për qëllime të tjera aktuariale);
- Të dhënat e motit dhe të tjera të indeksit të përafërt (të nevojshme për produktet e sigurimit sipas zonës);
- Çmimet historike dhe aktuale të kulturave dhe të kafshëve (sipas qarkut, shtetit, rajonit dhe vendit);
- Patologjinë e bimëve dhe të dhëna të tjera biologjike;
- Të dhënat eksperimentale të paraqitura grafikisht për kulturat bujqësore.

7.3. Ruajtja

Programet e sigurimeve bujqësore kërkojnë shumë të dhëna, kështu që ruajtja e të dhënave është e rëndësishme për ruajtjen e integritetit të programit. Në rastin ideal, të gjitha informacionet e sigurimeve duhet të ruhen dhe menaxhohen në një vend qendror të besuar nga të gjitha palët e interesuara. Niveli i fermës, performanca e produkteve dhe të dhënat e performancës së kompanisë duhet të mbledhen dhe mirëmbahen për të gjitha vitet. Çështjet e ruajtjes së të dhënave që duhet të trajtohen përfshijnë:

- Ku do të ruhen të dhënat?
- Ku do të ruhen rezerva të shumëfishta të të dhënave?
- Si do të menaxhohet siguria e të dhënave?
- Si do të formatizohen të dhënat për ruajtje dhe qasje në to?
- Cilat masa të sigurisë duhet të zbatohen?
- Kush do të ketë qasje në të dhëna?
- Cilat masa të kontrollit të cilësisë do të përdoren kur regjistrohen të dhënat?

7.4. Qasja

Konfidencialiteti i të dhënave duhet të ruhet në mënyrë të rreptë dhe qasja të kufizohet për palët përkatëse. Kopjet rezervë të të dhënave janë me rëndësi kritike për të parandaluar humbjen e të dhënave nga aksidenti ose keqpërdorimi.² Nëse ka problem me besimin ndërmjet qeverisë, shoqërive private të sigurimit, fermave dhe organizatave bujqësore, atëherë ruajtja e të dhënave duhet të bëhet nga një palë e tretë e besuar.

Nëse të dhënat ruhen në një vendndodhje qendrore, atëherë të gjithë pjesëmarrësit e programit duhet të kenë qasje në të dhënat përmbledhëse dhe në të dhënat e tyre konfidenciale, por jo në të dhënat konfidenciale të pjesëmarrësve të tjerë. Bordet e mbikëqyrjes dhe agjencitë rregullative duhet të kenë qasje në ato të dhëna konfidenciale për të cilat janë pajtuar të gjitha palët. Rregullat e konfidencialitetit duhet të respektohen rreptësisht përndryshe të ketë dënim me ligj.

7.5. Aktivitetet afariste

7.5.1. Ruajtja e dokumenteve (polisave të nënshkruara) dhe menaxhimi i tyre janë aspekte të rëndësishme të programeve të sigurimeve. Detajet që duhen marrë parasysh përfshijnë:

- Kush do t'i ruajë kontratat e nënshkruara të sigurimit?
- A do të përfshijnë kontratat e sigurimit referenca në dokumente të tjera apo do të jenë marrëveshje të pavarura?

Dokumentet duhet të nënshkruhen dhe të ruhen, dhe duplikatet duhet të mbahen në një vend të veçantë të sigurt.

7.5.2. Proceset e biznesit. Krijimi i besimit në programet e sigurimit të kulturave bujqësore kërkon zhvillimin dhe miratimin e proceseve të qëndrueshme të biznesit. Bizneset duhet:

- T'i edukojnë prodhuesit në mënyrë që ata r'i kuptojnë produktet para blerjes;
- T'i njohin dhe ulin në minimum kostot e fshehura për bujqit, auditorët dhe menaxherët.
- T'i zvogëlojnë shpenzimet e panevojshme.

^zKopja rezervë e të dhënave do të thotë mbajtja e të dhënave në shumë vende dhe mbajtja e dosjes origjinale në letër, duke mos u mbështetur vetëm në të dhënat elektronike.

8.0. Nënshkrimi i marrëveshjes dhe korrigjimi i humbjes

Nënshkrimi i marrëveshjes dhe korrigjimi i humbjes janë gurthemet e programeve të suksesshme të sigurimeve bujqësore. Nënshkrimi i marrëveshjes nënkupton detajet e përfshira në përgatitjen e kontratave të sigurimit të kulturave bujqësore duke përfshirë definicionet, proceset, vlerësimet dhe çështjet e zgjidhjes së kontesteve. Korrigjimi i humbjeve nënkupton proceset e përdorura për raportimin, verifikimin, përcaktimin e sasisë dhe dokumentimin e humbjeve që rezultojnë nga rreziqet e siguruara.

8.1. Nënshkrimi i marrëveshjes (underwriting)

Nënshkrimi i marrëveshjes përfaqëson proceset e përdorura për të përcaktuar sasinë dhe për kualifikimin e rreziqeve të portfolios së sigurimeve. **Përcaktimi i sasisë** së rrezikut nënkupton zhvillimin e masave të rrezikut për nën-popullatat ose individët. Kjo vlerë pastaj përkthehet në normat e primit për prodhuesit individualë. **Kualifikimi** i rrezikut nënkupton identifikimin e arsyeve për dallimet e rrezikut dhe vlerësimin e saktësisë së rreziqeve të bartura. Dallimet në praktikat e prodhimit ndërmjet prodhuesve individualë mund të shkaktojnë diferenca të konsiderueshme aktuariale, por në raste të tjera këto diferenca mund të jenë të parëndësishme për vlerësimin e rrezikut.

Nënshkrimi i marrëveshjes së sigurimeve bujqësore përdoret për ta identifikuar rrezikun individual të prodhuesit brenda një rajoni dhe një portfolio të sigurimeve. Nënshkrimi i marrëveshjes është i nevojshëm edhe për transferimin e rrezikut tek risiguruesit.

Nënshkrimi i marrëveshjes është një element kritik i programeve të sigurimit të kulturave bujqësore. Çështjet e mëposhtme duhet të trajtohen në aktivitetet e nënshkrimit të marrëveshjes:

- A janë aktivitetet e nënshkrimit të marrëveshjes favorizuese për praktikat e përgjegjshme të biznesit?
- A duhet që të gjitha produktet të kenë nënshkrim të marrëveshjes me procedura identike?
- A janë aktivitetet e marrëveshjes së sigurimit të produkteve të tilla që mund të përkrahen nga strukturat ekzistuese institucionale?

Marrëveshja e sigurimit kërkon që fermerët të kategorizohen në nën-popullata ose grupe brenda një portfolio të përgjithshme sigurimi. Ky proces duhet të kryhet para se të ofrohen produktet e



sigurimit.

Dizajni i programit dhe produktit shpesh përcaktojnë përqendrimin e marrëveshjes së sigurimit. Procese thelbësisht të ndryshme të marrëveshjes së sigurimit nevojiten për zhvillimin e produkteve individuale sipas prodhuesve në krahasim me produktet sipas indeksit të përafërt.

Zhvillimi dhe shkrimi i polisave me saktësi të lartë është një proces kompleks dhe që kërkon shumë kohë. Poliset janë marrëveshje kontraktuale obliguese. Prandaj, ato domosdoshmërisht duhet të shkruhen në terma teknike për ta zvogëluar dykuptimësinë. Materialet plotësuese që shpjegojnë detajet e polisave duhet të jenë në dispozicion të prodhuesve dhe agjentëve të sigurimeve. Hartimi i këtyre materialeve duhet të bëhet nga individë që e njohin mënyrën e edukimit të prodhuesve bujqësorë. Pasojat ligjore të formulimit të caktuar janë kritike për ruajtjen e integritetit të polisave dhe minimizimin e kontesteve. Komentet nga individët kompetentë përfshirë profesionistët ligjorë, aktuarët, profesionistët e sigurimeve, menaxherët e biznesit dhe të tjerët me ekspertizë bujqësore shpesh kërkojnë gjatë procesit të sigurimit.

Për produktet me bazë individuale, nënshkrimi i marrëveshjes duhet ta përcaktojë llojin e kulturës bujqësore që sigurohet. Për shembull, nuk mund të sigurohet një kulturë e përgjithshme e quajtur "grurë" për shkak të dallimeve në rendimentin dhe çmimin nëse është gruri pranveror, gruri dimëror apo gruri durum. Përveç kësaj, ekzistojnë dallime ndërmjet varieteteve të grurit në aspektin e praktikave të prodhimit dhe rendimenteve.

Sipërfaqja e siguruar duhet gjithashtu të përcaktohet. Për shembull, a do të sigurohet e tërë sipërfaqja e një prodhuesi me një kontratë të vetme, apo do të lejohen prodhuesit ta ndajnë sipërfaqen e tokës në bazë të njësive të ndryshme të siguruara? Mund të përcaktohet madhësia minimale e fermës për t'u kualifikuar për sigurimin e kulturave bujqësore.

Përfundimisht, nënshkrimi i marrëveshjes duhet t'i identifikojë ata që kualifikohen për të blerë sigurime (p.sh. pronarët e tokave, prodhuesit, trustet etj.). Nëse një produkt është projektuar për t'u mundësuar pronarëve të tokave të blejnë sigurime, duhet të ketë një mënyrë të nënshkrimit të rreziqeve të ndryshme dhe përcjelljes së marrëveshjeve të qirasë ndërmjet bujqve dhe pronarëve të tokave. Mund të ketë edhe nën-kontrata të ndryshme në të njëjtën fermë nëse, për shembull, dy individë në të njëjtën familje kanë pjesë të ndryshme të fermës dhe i menaxhojnë ato në mënyrë të pavarur.

Nënshkrimi i produkteve të bazuara në indeksin e sigurimit është relativisht më i lehtë sesa i produkteve individuale në bazë të rendimentit. Sidoqoftë, edhe me programet e bazuara në indeks, siguruesit duhet ta përcaktojnë pronësinë e kulturave bujqësore (bujqit e kualifikuar), a është rritur aktualisht kultura (bujqit e kualifikuar), kufijtë e përgjegjësisë, përshkrimet e indeksit të përafërt, hartimi dhe vlerësimi i produktit si dhe të merren parasysh rregullat e subvencioneve dhe të tjera.

8.2. Korrigjimi i humbjes

Korrigjimi i humbjeve nënkupton procesin e raportimit, matjes dhe vërtetimit të humbjeve që mbulojnë me kontratë sigurimi.

8.2.1. Procedurat. Në sigurimet bujqësore kërkohet korrigjimi i humbjeve për t'i vlerësuar kërkesat, për të monitoruar menaxhimin në terren, për të mbledhur dhe verifikuar të dhënat, për të kryer aktivitete të sigurimit, për t'i edukuar fermerët dhe për të kryer hulumtime në terren.

kërkesa dhe ato pa kërkesa. Meqë rendimentet e vitit kur nuk ka kërkesa përdoren për të azhurnuar rendimentet e pritshme dhe nivelet e kompensimit, këto rendimente duhet edhe të verifikohen çdo vit. Përfshirja e prodhuesit në procesin e korrigjimit të humbjeve kufizon ankesat dhe përmirëson rezultatet e zgjidhjes së kontesteve.

Shumica e programeve të sigurimit të kulturave bujqësore kërkojnë korrigjimin para korrjes. Gjatë inspektimeve para korrjeve, korrigjuesit e humbjeve duhet të:

- Përcaktojnë llojin e kulturës, vendndodhjen dhe madhësinë (hartën);
- Rishikojnë praktikën e menaxhimit të fermës;
- Identifikojnë anomalitë e praktikave të kultivimit;
- Identifikojnë fazën e një kulture në krahasim me specifikimet e politikave të sigurimit;



- Vendosin lokacionet e mostrave të tokave për vlerësimin e prodhimit (duke përfshirë përcaktimin e lokacioneve dhe rezultatet e numërimit të bimëve);
- Identifikojnë shkaqet e humbjeve të sigurueshme dhe jo të sigurueshme;
- Mbledhin të dhënat në terren;
- Verifikojnë/masin humbjen para korrjes;
- Plotësojnë, regjistrojnë dhe dorëzojnë formularët e kërkuar.

Procedurat e korrëgjimit të humbjeve shpesh përshtaten me karakteristikat specifike të produktit. Kjo vlen sidomos për produktet që përfshijnë kompensimin e ri-mbjelljes, përfitimet e ndalimit të mbjelljes (toka e pambjellur), ose përfitimet e dëmtimit gjatë dimrit.

8.2.1.1. Të korrat biologjike në krahasim me ato sipas mostrës.

Metoda e zakonshme ndaj korrëgjimit të humbjeve përfshin një vlerësim biologjik. Në këto raste, korrëgjuesi i humbjes vlerëson pjesë të vogla të arave të dëmtuara për t'i vlerësuar humbjet e rendimentit. Korrëgjuesit përgjithësisht i numërojnë bimët dhe sasinë e produktit të mbetur në secilën bimë. Këto të dhëna përdoren së bashku me hapësirën ndërmjet rendeve të kulturave bujqësore për ta përcaktuar rendimentin potencial të një are. Në fund, korrëgjuesit shpesh kërkojnë shenja të dëmtimit si kokrrat e vogla të drithit në tokë të cilat nuk mund të korren dhe të ketë fitim prej tyre. Procesi është hartuar për ta përcaktuar rendimentin potencial dhe aktual të një kulture.

Megjithëse përdoren më rrallë, disa programe sigurimi u mundësojnë korrëgjuesve të humbjeve për të kryer mostra të korrjes për ta përcaktuar rendimentin aktual. Në këtë rast, korrëgjuesit në të vërtetë e korrin një pjesë të një are dhe matin prodhimin për ta përcaktuar rendimentin e korrjes. Natyrisht, nëse korrëgjuesit duhet të përdorin pajisjet e tyre të korrjes për ta arritur këtë konkludim, procesi mund të jetë shumë i kushtueshëm. Nga ana tjetër, përdorimi i pajisjeve bujqësore të fermerëve paraqet probleme të tjera. Kjo do të thotë që korrëgjuesi duhet të ketë njohuri për aktivitetin dhe kalibrimin e një shumëllojshmërie të pajisjeve të korrjes për ta marrë rendimentin e saktë.

Matja e sasisë së prodhimit që është deponuar përfaqëson një kombinim të këtyre dy metodave. Do të thotë, korrëgjuesi i humbjes mund ta masë sasinë e prodhimit të deponuar për t'i përcaktuar rendimentet. Megjithatë, kjo metodë supozon që mund të matin saktësisht kulturat e deponuara më parë. Por, shpesh është e vështirë të identifikohet burimi i mallrave të deponuara. Për më tepër korrëgjuesi duhet ta verifikojë që është ruajtur i tërë prodhimi.



8.2.2. Sistemet e zgjidhjes së kontesteve janë të ngjashme në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara. Pasi një korrigjues i humbjes e përcakton shkallën e një humbjeje, prodhuesi që nuk pajtohet me këtë vendim mund të kërkojë që një rregullues i dytë, më me përvojë, i humbjes, të japë një opinion. Prodhuesi ose mund ta pranojë gjykimin e dytë ose të dorëzojë ankesë te një komision arbitrazhi. Këto komisione zakonisht formohen brenda rajonit të kontestit dhe përbëhen nga një person nga bordi i drejtorëve dhe disa fermerë të trajnuar në zgjidhjen e kontesteve. Si fermeri ashtu edhe siguruesi paraqesin dëshmi për përkrahjen e qëndrimeve të tyre dhe komisioni merr një vendim. Megjithëse prodhuesit mund ta dorëzojnë kontestin në sistemin e gjykatave, gjykatat shpesh anojnë kah vendimi i marrë nga komisioni, përveç nëse janë bërë gabime procedurale.

Korrigjuesit kanadezë të humbjeve janë punonjës të agjencisë qeveritare që ofron shërbime të sigurimit të kulturave bujqësore. Prandaj, ata nuk kanë nevojë të sigurohen kundër përgjegjësisë profesionale. Në Shtetet e Bashkuara, korrigjuesit e humbjeve janë kontraktorë të pavarur. Megjithatë, ata konsiderohen të ngjashëm me punonjësit e qeverisë, sepse veprojnë në emër të qeverisë. Korrigjuesit përgjithësisht mbrohen nga përgjegjësia civile që përfshin gabime të thjeshta. Megjithatë, korrigjuesit që kryejnë mashtrime i nënshtrohen ndjekjes penale.

9.0. Risigurimi

Risigurimi është një komponent i rëndësishëm i një programi funksional të sigurimit të kulturave. Në programin e SHBA-ve, detyrimet totale shpërndahen nëpër disa subjekte. Duke mos marrë parasysh grupin e caktuar të rrezikut nga qeveria, siguruesit primarë bartin ndërmjet 0-5% të rreziqeve të sigurimit të kulturave, risiguruesit bartin ndërmjet 20-25%, dhe qeveria merr 70-75%. Sa i përket pagesave historike të kompensimeve, siguruesit primarë paguajnë 4-8% të të gjitha kompensimeve, risiguruesit paguajnë 92-96%, dhe në vitet e fundit, qeveria e SHBA ka paguar 0%.

Nëse 14% e të gjitha polisave të caktuara përfshihen në grupin e rrezikut të qeverisë amerikane (një grup i kontratave me rrezikun më të lartë), atëherë siguruesit primarë paguajnë 3-7% të të gjitha kompensimeve, risiguruesit paguajnë 86-90%, dhe qeveria amerikane ka paguar 6-7% në vitet e fundit.

Për programet e sigurimeve të zhvilluara mirë në të cilat ka pjesëmarrje të gjerë në shumë sektorë bujqësorë, do të ishte shumë e vështirë që pagesat totale të kompensimeve në një vit të caktuar të tejkalojnë tri herë primet e përgjithshme vjetore.

9.1. Hyrje në risigurime

Risigurimi është bartja e rrezikut nga një kompani (p.sh një agjenci lëshuese ose sigurues primar) tek një kompani tjetër e sigurimit (p.sh risigurues) ose qeveria. Produktet e sigurimit të kulturave bujqësore nuk do të ishin të realizueshme pa një treg efektiv të risigurimeve.

Risiguruesit zakonisht janë kompani sigurimi të mëdha që janë të diversifikuara mirë në të gjithë hapësirën, sektorin dhe llojet e sigurimeve. Diversifikimi në hapësirë do të thotë se këto kompani veprojnë në shumë vende dhe rajone në mbarë botën. Diversifikimi në sektorë nënkupton që këto kompani sigurojnë një sërë sektorësh ekonomikë, përfshirë banimin, pronën komerciale dhe pasurinë e paluajtshme. Diversifikimi në llojet e sigurimeve ndodh nëpërmjet risigurimit të prodhimit bujqësor, pronës, viktimave, shëndetit dhe produkteve të sigurimit të jetës. Kompanitë e risigurimit duhet të jenë mjaft të mëdha për të përballuar shumë rreziqe të mëdha dhe për të menaxhuar portfolio të ndryshme.

Nga vetë natyra e tyre, produktet e sigurimit të kulturave bujqësore përpiqen të sigurojnë prodhuesit kundër ndodhjeve individuale (p.sh., breshër) dhe ndodhjeve në tërë rajonin (p.sh., thatësira). Ndodhitë e pafavorshme të motit në rajon kanë pasur si rezultat shumë pagesa të mëdha të kompensimeve në një vit dhe pak kompensime të paguara



gjatë viteve të tjera. Agjencitë lëshuese zakonisht nuk kanë rezerva të mjaftueshme financiare për të absorbuar vitet e pagesave të larta të kompensimeve. Agjencitë lëshuese kanë një portfolio të sigurimeve jo të diversifikuar për shkak të natyrës së specializuar të sigurimit të kulturave bujqësore dhe ndodhive rajonale. Prandaj, risigurimi është veçanërisht me rëndësi për programet e sigurimit të kulturave bujqësore, pasi një ndodhi që ndodh në tërë rajonin ka gjasa të zbrazë rezervat e parave të kompanive lëshuese. Përveç kësaj, shumica e kompanive lëshuese nuk janë të diversifikuara deri në atë pikë sa të mund t'i menaxhojnë këto rreziqe substanciale. Kompanitë e risigurimit kanë rezerva të mjaftueshme të parasë dhe diversifikim të portfolios për të siguruar ndodhi që shfaqen në tërë rajonin sepse ato veprojnë në shumë rajone.

9.2. Vlerësimi i risigurimit

Risiguruesit duhet ta përcaktojnë çmimin me të cilin ata janë të gatshëm ta pranojnë rrezikun nga agjencitë lëshuese. Ngjashëm me sigurimin e kulturave bujqësore, risiguruesit duhet gjithashtu t'i vlerësojnë rreziqet që i pranojnë. Vlerësimi i risigurimit është funksion i distribucionit të probabilitetit përkatës të pagesave të kompensimit, llojeve të sigurimeve që merren parasysh, kostove të ofrimit të shërbimeve të risigurimit dhe politikave publike që lidhen me programet e sigurimeve.

Kompanitë e risigurimit mbështeten tek brokerët për të marrë punë. Brokerët angazhohen sepse shpesh ata i kuptojnë më mirë çështjet, interesat dhe mundësitë në fusha specifike. Brokerët organizojnë propozime biznesi të risigurimeve për kompanitë e risigurimit.

9.2.1. Llojet. Ekzistojnë disa lloje të risigurimeve dhe marrëdhënieve ndërmjet risiguruesve. Rrallë ndodh që një kompani sigurimi primare të jetë në pronësi të një risiguruesi.

9.2.1.1. Bashkë-pagesat, bashkë-sigurimi ose pjesëmarrja me përqindje. Bashkëpagesat nënkupton ndarjen proporcionale të humbjeve ndërmjet një kompanie primare të sigurimit dhe risiguruesve.

Nëse një kompani e risigurimit pranon 40% të rrezikut të pagesës së kompensimit dhe një tjetër pranon 60%, atëherë dy kompanitë i ndajnë pagesat e kompensimit në bazë 40/60.

Edhe në një sistem me bashkë pagesa, kompania primare e sigurimit mund të kërkohej të paguajë një zbritje - shpesh edhe aq sa 5% të detyrimit. Zbritja përfaqëson shumën e humbjes që ofruesi i sigurimeve primare e bart para transferimit të përgjegjësisë së humbjes të risiguruesi. Nëse siguruesi primar nuk ka përgjegjësi të zbritjes ose të bashkëpagesës, normat e risigurimit janë tepër të mëdha dhe reflektohen në primet e risigurimit.

9.2.1.2. Ndalimi i humbjes është një shumë me të cilën pagesat e mbetura të kompensimit transferohen te një njësi tjetër. Në përgjithësi, vetëm qeveritë (me burimet e tyre të mëdha dhe mandatet e politikave publike) janë të gatshëm dhe në gjendje të pranojnë rreziqe të mëdha kompensimi. Pa marrëveshjet për ndalimin e humbjeve, kompanitë e risigurimit në përgjithësi nuk do të ishin të gatshëm të risiguronin rreziqet e sigurimeve bujqësore. Në shumë raste, niveli i ndalimit të humbjes është i vendosur në tre ose pesë herë sa primet e përgjithshme vjetore.

9.2.1.3. Risigurimi me shtresa, nivele apo këste nënkupton situatat në të cilat komponenti i parë i rrezikut pranohet nga një subjekt përpara se subjekti i dytë të pranojë ndonjë rrezik. Risigurimi i shtresuar mund të definohet ose si përqindje ose si shuma të caktuara. Çdo subjekt është përgjegjës për një shumë të caktuar të humbjes bazuar në një strukturë hierarkike.



Shembull: Risigurimi me nivele proporcionale: \$1,000,000,000 detyrimi.

Subjekti	Përgjegjësia e humbjes	
	Përqindja	Shuma (milion dollarë)
Siguruesi Primar	5%	50
Risiguruesi kryesor	15%	150
Risiguruesi sekondar	20%	200
Qeveria	60%	600

Ky shembull jep një ilustrim të risigurimit me nivele proporcionale. Ofruesi i sigurimit primar e pranon rrezikun fillestar prej 5% të kompensimit (d.m.th pagesat e kompensimit), risiguruesi kryesor pranon 15%, një risigurues sekondar pranon 20% dhe qeveria pranon 60% të fundit. Detyrimi total është 1 miliardë dollarë. Në këtë rast, nëse kërkesat për kompensime në një vit të caktuar gjithsej janë 5% ose më pak të detyrimit total, vetëm siguruesi primar do të paguajë kompensimet (deri në total \$ 50.000.000). Megjithatë, nëse kërkesat tejkalojnë \$ 50,000,000, por janë më pak se \$ 200,000,000 (më pak se 20% e detyrimit total), atëherë përgjegjësia totale e kompensimit të siguruesit primar do të kufizohet në 50,000,000 \$ dhe risiguruesi kryesor do të ishte përgjegjës për 150,000,000 të mbetura. Risiguruesi sekondar do të ishte përgjegjës për shumën e ardhshme prej \$ 200,000,000 dhe në fund 600,000,000 \$ të mbetura do të ishte përgjegjës e qeverisë.

Shembull: Risigurimi me nivele fikse: \$1,000,000,000 detyrimi.

Situata	Totali i kompensimeve të paguara	Pagesa e humbjes (në milion dollarë)			
		Siguruesi Primar	Risiguruesi kryesor	Risiguruesi sekondar	Qeveria
A	50	50	0	0	0
B	125	50	75	0	0
C	300	50	150	100	0
D	500	50	150	200	100

Ky shembull ilustron një situatë në të cilën kompensimet janë shpërndarë në shumë fikse. Situata A përfaqëson një rast në të cilin pagesat totale të kompensimeve do të ishin 50,000,000 \$. Siguruesi primar mund të jetë përgjegjës për të gjithë shumën. Megjithatë, situata B kërkon pagesa totale të kompensimit prej \$ 125,000,000. Në këtë rast, përgjegjësia e siguruesit primar do të kufizohet në 50,000,000 \$ dhe risiguruesi kryesor do të paguante 75,000,000 \$ të mbetura. Për situatat C dhe D, kompensimet totale të paguara janë \$ 300,000,000 dhe \$ 500,000,000 respektivisht.

9.2.2. Kostot. Siguruesit primarë negociojnë me risiguruesit mbi koston dhe kushtet e risigurimit.

Siguruesit primarë duan të paguajnë çmimin më të ulët të mundshëm për risigurim ndërsa të transferojnë sasinë më të madhe të rrezikut të mundshme. Negociatat përqëndrohen në shumë faktorë duke përfshirë primet e rrezikut të pastër, ngarkesat, shpenzimet e shërbimit, dizajnin e programit, integritetin e programit, transparencën dhe auditimin, çështjet politike, gjyqësore dhe ligjore, kompetencat e personelit, zbulimin dhe kontrollin e mashtrimit dhe reputacionin e palëve të përfshira.

9.3. Grupimi i sigurimeve.

Siguruesit primarë i paguajnë risiguruesit ta pranojnë pjesën më të madhe të rrezikut të shkaktuar përmes shitjes së kontratave të sigurimit. Çmimi që siguruesit primarë e paguajnë për ta transferuar këtë rrezik varet nga disa faktorë, duke përfshirë shkallën deri në të cilën produktet e tyre të shitjes, procedurat e biznesit dhe aktivitetet e korigjimit të humbjeve janë të standardizuara në të gjitha produktet, rajonet dhe kompanitë. Përveç kësaj, çmimi i risigurimit varet nga sasia e rrezikut që siguruesi primar është i gatshëm ta mbajë dhe nëse kompania lëshuese vendos të mbajë ose transferojë aktivitetet e shërbimit dhe menaxhimin e të dhënave.

9.3.1. Produktet e standardizuara. Programet e sigurimit të kulturave bujqësore shpesh ofrojnë një shumëllojshmëri produktesh, duke përfshirë produktet e rendimentit dhe të ardhurave me shumë rreziqe, produktet e individualizuara, produktet në tërë zonën dhe produktet e sigurimit me indeks të përafërt. Në shumë raste, produkte të ndryshme ofrohen për kulturat bujqësore të ngjashme në rajone të ndryshme. Kjo sigurisht ndodh me kompanitë që veprojnë në një shkallë globale. Shkalla në të cilën produkte të ngjashme mund të grupohen për shitje te një risigurues në masë të madhe ndikon në çmimin e transferimit të rrezikut. Standardizimi zvogëlon kostot teknike, të monitorimit dhe të menaxhimit të risiguruesve. Prandaj, transferimi i rrezikut nga produktet homogjene është më pak i kushtueshëm për një sigurues primar sesa ai që del nga shërbimi i produkteve heterogjene.

9.3.2. Procedurat e standardizuara afariste. Risiguruesit gjithashtu janë të gatshëm ta pranojnë rrezikun nga siguruesit primarë me kosto më të ulët nëse procedurat e biznesit të këtij të fundit janë relativisht të standardizuara në të gjitha produktet. Ngjashmëria ndërmjet procedurave të kontabilitetit dhe raportimit, strategjive të shitjes, auditimit, menaxhimit të parasë së gatshme, arkëtimit të primeve, dhe pagesave të kompensimit kontribuojnë në uljen e kostove të risiguruesit. Kështu, siguruesit primarë duhet të zhvillojnë dhe ofrojnë produkte brenda praktikave standarde të përcaktuara të biznesit. Një aktivitet i tillë kontribuon edhe në zhvillimin e transparencës dhe besimit në sistemet e biznesit.

9.3.3. Korrigjimi i standardizuar i humbjeve. Ngjashëm, korrigjimi i standardizuar dhe i dokumentuar mirë i humbjeve është i rëndësishëm për zvogëlimin e kostove të risigurimit. Natyrisht, metodat e korrigjimit të humbjeve do të ndryshojnë për produkte të ndryshme (p.sh., sigurimi i rendimentit me rrezik të shumëfishtë në krahasim me produktet e sigurimit sipas indeksit të përafërt). Megjithatë, duhet patjetër të promovohen procedurat e ngjashme të korrigjimit të humbjeve brenda klasave të produkteve dhe, kur është e mundur, në llojet e ndryshme të kulturave bujqësore.

9.3.4. Mbajtja dhe transferimi i rrezikut të grupit. Risiguruesit shpesh kërkojnë që të paktën 5% të para të detyrimit të sigurimit të të mbjellës të mbeten me siguruesin kryesor. Në thelb, kjo vepron si një zbritje për risiguruesin dhe ndihmon në uljen e rrezikut moral dhe të problemeve të përzgjedhjes së pafavorshme lidhur me siguruesit primarë. Përveç kësaj, ofrimi i bashkë-pagesave, bashkë-sigurimit ose pjesëmarrja në përqindje ndihmon në uljen e problemeve të sjelljes së rrezikut moral dhe zvogëlon rreziqet e krijuara nga risiguruesit. Ky zvogëlim i ul tarifat e ngarkuara nga risiguruesit për ta pranuar rrezikun.

9.3.5. Mekanizmat alternative të transferit të rrezikut. Grupimi i sigurimeve përfshin edhe metoda të ndryshme për transferimin e rrezikut. Në disa raste, ofruesit e sigurimeve lehtësojnë ndalimin e humbjes dhe ndarjen e rrezikut me qeveritë. Në raste të tjera, ofruesit e sigurimeve primare bien dakord të vazhdojnë pagesën e kontratave, edhe pse pjesa më e madhe e rrezikut të lidhur me ato kontrata është transferuar në një risigurues.



10.0 Sjellja e paligjshme

Për fat të keq, sigurimi i kulturave bujqësore shpesh jep një mundësi për sjellje të paligjshme. Procedurat e rrepta të nënshkrimit të marrëveshjes, menaxhimit të produktit dhe menaxhimi i duhur mund ta minimizojnë sjelljen e padëshiruar.

Burime të ndryshme të mundshme për sjellje të paligjshme, duke përfshirë rrezikun moral, përzgjedhjen e pafavorshme dhe mashtrimet ekzistojnë brenda të gjitha programeve të sigurimeve. Disa nga këto sjellje janë veçanërisht të rëndësishme për produktet e sigurimit të kulturave bujqësore.

10.1 Rreziku moral

Rreziku moral ndodh kur prodhuesit veprojnë në mënyra që rrisin mundësinë e marrjes së kompensimeve. Konkretisht, rreziku moral nënkupton veprimet e ndërmarra nga prodhuesit që nuk do të ndodhnin në mungesë të sigurimit të kulturave bujqësore. Në përgjithësi, rreziku moral nuk nënkupton aktivitetet mashtruese.

Shembull: *Prodhuesit shpesh kanë opsione në lidhje me cilësinë e farërave që përdoren për ta prodhuar një kulturë. Fara me cilësi më të lartë prodhon rendiment më të mirë, por është më e shtrenjtë. Cilësia më e ulët dhe farërat me çmim më të ulët shpesh rezultojnë në rendiment më të ulët.*

Nëse një prodhues e ka blerë një kontratë sigurimi të bazuar në rendiment, stimulimi për të përdorur kosto më të ulët dhe farë me rendiment më të ulët rritet, sepse rendimentet e ulëta do të kompensohen disi nga pagesat e kompensimit. Përveç kësaj, prodhuesit që kanë blerë sigurimin e kulturave bujqësore mund të jenë më pak syçelë gjatë monitorimit të infektimit me farë të keqe dhe insekte ose mund të jenë më pak të vëmendshëm ndaj kohës së ujitjes ose përpjekjeve për korrje.

Shkalla e rrezikut moral dallon sipas dizajnit të programit. Potenciali për rrezik moral është më i lartë në produktet e sigurimit me rendiment individual të prodhimeve që bazohen në zona të vogla të tokës së bujkut. Pothuajse nuk ka rrezik moral me produktet e sigurimit që bazohen në rendimentet sipas zonës, të ardhurat sipas zonës ose indeksin e përafërt.



Rreziqet morale zakonisht janë rezultat i informacionit asimetrik. Informacioni asimetrik nënkupton rastet në të cilat njëra palë (zakonisht një prodhues) ka përparësi sepse ka më shumë informacion në lidhje me ndryshueshmërinë e rendimentit sesa pala tjetër (zakonisht një kompani sigurimesh). Nëse këto asimetri ekzistojnë, atëherë kontratat e sigurimit duhet të shkruhen me kujdes për të ulur efektet e rrezikut moral.

Ndikimet e rrezikut moral mund të zvogëlohen në mënyra të ndryshme. Zgjidhja e parë dhe më e dukshme është përmes monitorimit të kujdesshëm, por monitorimi intensiv është i shtrenjtë dhe i shton kostot e produkteve të sigurimit. Këto kosto duhet ose të mbulohen nëpërmjet primeve më të larta ose subvencioneve më të larta.

Një tjetër zgjidhje e mundshme është që të përdoren nivelet që aktivizojnë kompensimin që nuk mund të ndryshohen nga i siguruari. Rendimenti i zonës, të ardhurat dhe produktet e indeksit të përafërt zvogëlojnë rrezikun moral për këtë arsye. Në fund, përdorimi i zbritjeve të larta ose bashkë-pagesave e zvogëlon efektin e rrezikut moral. Aktivitetet me rrezik moral zakonisht ndodhin kur rendimentet aktuale të të korrave janë të afërta me aktivizuesit e kompensimit. Rritja e zbritjeve ose bashkëpagesave pakëson gjasat që një prodhues të jetë pranë niveleve që e aktivizojnë kompensimin.

10.2 Përzgjedhja e pafavorshme

Përzgjedhja e pafavorshme ndodh kur palët e ndryshme kanë qasje në informacione të ndryshme. Në përgjithësi, asimetritë ndodhin kur i siguruari ka më shumë informacion në lidhje me potencialin e rendimentit dhe shpërndarjet se sa siguruesi.

Prodhuesit e kulturave bujqësore identike mund të përballen me rreziqe të ndryshme, por shpesh i kanë planet e ngjashme të primeve. Ofruesit e sigurimeve shpesh nuk janë në gjendje të bëjnë dallimin ndërmjet prodhuesve me rrezik të lartë dhe atyre me rrezik të ulët, por prodhuesit me rrezik të lartë janë më të gatshëm të blejnë sigurime sesa prodhuesit me rrezik të ulët. Prandaj, ofruesit e sigurimeve shpesh gjenden me një grup të madh prodhuesish me rrezik të lartë që paguajnë primet që janë llogaritur bazuar në pjesëmarrësit me rrezik të lartë dhe të ulët.

Përzgjedhja e pafavorshme mund të zvogëlohet nëse grupet mund të formohen në mënyrë që rreziku brenda secilit grup të jetë më homogjen dhe të vlerësohet në atë bazë. Shpesh, grupet formohen sipas rajonit, kulturave bujqësore, dhe rendimenteve të ndryshme.

Pjesëmarrja e detyrueshme në sigurim pothuajse tërësisht eliminon përzgjedhjen e pafavorshme. Kërkesat e përputhshmërisë shpesh krijojnë rezultate të ngjashme. Produktet e Indeksit të përafërt gjithashtu zvogëlojnë rezultatet e përzgjedhjes së pafavorshme. Sidoqoftë, mund të ndodhin probleme të tjera të përzgjedhjes nëse rezultatet e rendimenteve të disa prodhuesve individualë relativisht nuk kanë korrelacion me procesin e aktivizimit të indeksit të përafërt. Niveli i aversionit ndaj rrezikut i një prodhuesi do ta inkurajojë pjesëmarrjen nëse pagesat e kompensimit kanë korrelacion të lartë me humbjet.

10.3 Erozioni i pjesëmarrjes

Erozioni i pjesëmarrjes ndodh kur ofruesit e sigurimeve i përgjigjen rrezikut moral ose problemeve të përzgjedhjes së pafavorshme duke rritur normat e primit. Megjithatë, primet më të larta ofrojnë stimulime për prodhuesit me rrezik më të ulët që të dalin nga grupi i sigurimeve, duke rezultuar në një grup me një përqindje relativisht më të lartë të prodhuesve me rrezik të lartë. Ndërsa procesi përsëritet, normat e primit të sigurimit duhet të rriten deri në pikën ku vetëm prodhuesit me rrezikun më të lartë do të blejnë sigurime. Erozioni i pjesëmarrjes në fund mund ta bëjë ofrimin e sigurimit të pamundur.

Ka disa mënyra për ta zvogëluar erozionin e pjesëmarrjes. Ndarja e prodhuesve në grupe të ndryshme rreziku mund të ndihmojë. Për shembull, nëse mund të identifikohen prodhuesit me rrezik të lartë, në krahasim me ata me rrezik të ulët, këto grupe mund të ndahen, gjë që mundëson që primet të llogariten në përputhje me rrezikun aktual. Ndryshueshmëria historike e rendimenteve është një mënyrë për t'i ndarë prodhuesit sipas profilit të rrezikut. Përveç kësaj, qeveritë mund të subvencionojnë primet në mënyrë që sigurimi të jetë i dëshirueshëm për të gjithë prodhuesit. Një opsion tjetër është që të merren nivele të ndryshme të aversionit ndaj rrezikut bazuar në karakteristikat socio-ekonomike. Për shembull, fermerët që punojnë për ekzistencë shpesh janë shumë të rrezikuar, sepse një rendiment i vetëm i dobët mund të ketë si rezultat pamundësinë për ta siguruar bukën.

10.4 Mashtrimi

Mashtrimi ndodh kur prodhuesit përpiqen të rrisin pagesat e


kompensimit duke shkëlur kontratat e tyre të sigurimit.

53

Mashtrimi në sigurimin e kulturave bujqësore më së shpeshti

36

HYRJE NË SIGURIMET BUJQËSORE DHE MENAXHIMIN E RREZIKUT



ndodh kur prodhuesit raportojnë më pak rendimente, manipulojnë historitë e rendimentit, ose i korrutojnë korrigjuesit e humbjeve. Janë zhvilluar shumë metoda për të zbuluar mashtrimet, duke përfshirë:

- Monitorimin aktiv të progresit të kulturave bujqësore dhe rendimenteve të korrjes;
- Shqyrtimin e të dhënave për anomalitë në raportet e rendimenteve, në pagesat e kompensimeve dhe korrelacionet e rendimentit sipas lokacionit;
- Dizajnimi i produkteve që zvogëlojnë potencialin për aktivitete mashtruese (p.sh. indeksi i përfaqësuesit dhe produktet sipas zonës);
- Zbatimin rigoroz të rregullave dhe rregulloreve dhe caktimin e dënimeve të larta për mashtrim. Programet efektive dhe të publikuara mirë të zbulimit të mashtrimit duhet të krijohen së bashku me dizajnimin e programeve të sigurimeve.

11.0 Përgjegjësitë e Qeverisë

Qeveria ofron një shumëllojshmëri të shërbimeve të sigurimit edhe nëse programi zbatohet gjerësisht nga sektori privat.

11.1 Rregulloret

Rregulloret janë një komponent i rëndësishëm i politikës publike në lidhje me sigurimin e kulturave bujqësore. Politika publike duhet të rrisë dhe garantojë zbatimin e kontratave në mesin e ofruesve të sigurimeve, risiguruesve dhe të siguruarve.

Kontratat e sigurimit duhet të gjykohen vazhdimisht. Respektimi i ligjit të kontratave siguron transparencën dhe besimin e nevojshëm në programet e sigurimeve bujqësore.

Integriteti financiar i siguruesve primarë është kritik për një program të suksesshëm të sigurimeve bujqësore. Siguruesit duhet të mbajnë shënime të sakta për kontratat e polisave, arkëtimin e primeve, transferet e subvencioneve dhe korigjimet e humbjeve. Përveç kësaj, firmat duhet të kenë rezerva të mjaftueshme financiare për ta kryer biznesin dhe për të dhënë menjëherë pagesat e kompensimit. Agjencitë qeveritare ose palët e treta duhet të monitorojnë praktikën e biznesit financiar të siguruesve primarë.

11.2 Auditimi dhe mbikëqyrja

Politika publike është e përfshirë drejtpërdrejt në funksionet e auditimit dhe mbikëqyrjes.

Funksioni kryesor i auditimit është të garantojë që siguruesit primarë dhe risiguruesit të përmbushin përgjegjësitë e tyre të pranuar. Përveç kësaj, politika publike duhet të jetë e mjaftueshme për të përmbushur angazhimet e qeverisë lidhur me ndalimin e humbjeve, risigurimet ose dhënien e subvencioneve.

Pagesat e subvencioneve përfaqësojnë transferimin e burimeve nga taksapaguesit tek prodhuesit bujqësorë dhe/ose kompanitë e sigurimeve. Prandaj, rrjedha dhe përdorimi i këtyre fondeve duhet të monitorohen për të garantuar integritetin e procesit. Procesit duhet të jetë transparent në mënyrë që tatimpaguesit të mund ta shohin se fondet përdoren sipas qëllimit të caktuar. Politika publike duhet të sigurojë mbikëqyrje në lidhje me pagesën dhe shfrytëzimin e subvencioneve. Për shkak se burimet qeveritare janë të kufizuara në aspektin e burimeve financiare dhe të personelit, është e rëndësishme të identifikohen rolet dhe aktivitetet thelbësore të qeverisë. Nëse nuk kryhen nga qeveria, këto role duhet të kryhen nga subjekte private ose palë të treta.

Nëse një shumëllojshmëri e kompanive të sigurimit dhe risigurimit



janë të përfshira në dizajnin dhe administrimin e produktit, ka të ngjarë që normat e primit të ndryshojnë - madje edhe për produkte identike ose të ngjashme - si rezultat i rregullave unike të vlerësimit, qëllimeve të profitit, preferencave të rrezikut dhe burimeve financiare. Rrjedhimisht, mund të jetë e nevojshme që të racionalizohen këto dallime nëpër kompani, produkte dhe rajone të ndryshme. Përveç kësaj, siguruesit primarë kanë stimulim për t'i mbivlerësuar normat e primit për produktet që marrin subvencione qeveritare.

Agjencitë qeveritare në përgjithësi kryejnë shumë nga funksionet e mësipërme, por grupet e palëve të treta mund të kryejnë disa detyra të cilat e lehtësojnë barrën e agjencive qeveritare dhe ofrojnë ekspertizë shtesë. Përdorimi i palëve të treta mund të jetë edhe më ekonomik.

Në disa vende, kompanitë e sigurimeve shqyrtohen dhe monitorohen nga auditorët e palëve të treta gjatë aktiviteteve normale të biznesit. Nëse mund të shmangen konfliktet e interesit, këta auditorë mund të ndihmojnë edhe në monitorimin e çështjeve që lidhen me kontabilitetin e sigurimit të kulturave. Paratë e ndara (check off dollars) nga çdo polisë mund të depozitohen në një llogari që ndihmon të paguhet monitorimi nga pala e tretë. Edhe rezerva mund të përdoret si sigurim kundër mospagimit nga cilado kompani e sigurimit.

Programet e barabarta të sigurimeve bujqësore i trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Barazia nuk mund të arrihet nëse vendimet nuk merren dhe nuk zbatohen në mënyrë konsistente. Transparenca dhe konsistenca janë të domosdoshme për drejtësi, që arrihet vetëm nëse të gjithë pjesëmarrësit i kuptojnë qartë shkëmbimet dhe detajet e produkteve të sigurimit të kulturave bujqësore.

Përveç kësaj, programet duhet të monitorohen për ta garantuar zbatimin konsistent të tyre dhe zbatimin e rregullave. Monitorimi duhet të përfshijë:

- Auditimet e brendshme të standardeve për korrigjimin e humbjeve;
- Proceset që pengojnë që "fitimi" të ndikojë në rezultatet e korrigjimit të humbjeve;
- Përdorimi i korrigjuesve të pavarur të humbjeve;
- Auditimi i jashtëm nga palë të treta.

11.3 Gjqësorja dhe ligjorja

Sistemet gjyqësore dhe ligjore të vendit specifik duhet të zbatohen në mënyrë të drejtë ligjin e kontratave dhe të pronësisë. Kontratat duhet të zbatohen në mënyrë konsistente pavarësisht ofruesit të sigurimeve ose të siguruarit. Zbatimi duhet të jetë i barabartë për të gjitha palët dhe individët.

Agjencitë qeveritare duhet të përfshihen në zbatimin e marrëveshjeve kontraktuale. Përveç kësaj, mund të jetë e dëshirueshme edhe përfshirja e qeverisë në arbitrazh.

11.4 Subvencionet

Politika publike duhet ta përcaktojë rolin dhe fushëveprimin e subvencioneve të sigurimeve bujqësore. Për shembull, është e mundur të ofrohen subvencionet drejtpërdrejtë te prodhuesit ose indirekt nëpërmjet ofruesve të sigurimeve ose risigurimeve. Hartuesit e politikave duhet të vendosin nëse qëllimet përmbushen më së miri përmes subvencionimit të primeve të sigurimit apo përmes ofrimit të burimeve të administrimit dhe operimit direkt tek sigurveit. Kompanitë e risigurimit janë përgjithësisht të interesuara për pranimin e rrezikut për portfoliot që kanë një vlerë minimale fillestare të detyrimit prej 200 milionë dollarë me potencial për rritje deri në 1 miliardë dollarë. Subvencionet inkurajojnë pjesëmarrjen në sigurime bujqësore dhe mund të jenë të nevojshme për të krijuar vëllim të mjaftueshëm që nevojitet për risigurim.

11.4.1. Subvencionet e primeve dhe shërbimit. Qeveritë shpesh luajnë rol të rëndësishëm në subvencionimin e programeve të sigurimeve bujqësore. Subvencionet mund të jenë në formën e zvogëlimit të primeve, kontributeve në shpenzimet administrative dhe operative të sigurveit, aktivitetet e risigurimit dhe ndalimit të humbjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe auditimin, si dhe ndikimet në tregti dhe politikat ndërkombëtare.

Qeveritë përdorin një sërë metodash për ofrimin e subvencioneve të primeve, duke përfshirë subvencionimin e primeve me një shumë të caktuar për hektar për një kulturë bujqësore të dhënë në një rajon të caktuar. Shumat shpesh ndryshojnë sipas kulturave bujqësore dhe rajonit, dhe subvencionet mund të paguhen ose direkt tek prodhuesit ose tek kompanitë e sigurimeve.

Qeveritë mund të subvencionojnë primet edhe me përqindje. Subvencionet me përqindje shpesh janë më të mëdha për zbritjet më të larta dhe më të vogla për zbritjet më të ulëta. Kjo u ofron fermerëve stimulim për të zgjedhur nivel të ulët të mbulimit dhe zvogëlon detyrimin total të sigurveit primar dhe mundësitë për aktivitetet e rrezikut moral të prodhuesve. Kostot e ofrimit të subvencioneve (d.m.th. shërbimit) janë përgjithësisht një përqindje konstante e primeve të rrezikut të pastër për

produkte të ngjashme të sigurimit. Megjithatë, kostot ndryshojnë sipas produktit të sigurimit. Për shembull, produktet e sigurimit sipas zonës janë më pak të kushtueshme për t'u administruar sesa produktet e sigurimit të fermave individuale.

Në shumë vende - duke përfshirë Shtetet e Bashkuara - nivelet e ulëta të mbulimit të sigurimeve (Sigurimi i kulturave bujqësore nga katastrofat) u ofrohen prodhuesve pa pagesë.

11.4.2. Risigurimi publik. Politika publike është një dimension i rëndësishëm për risigurimet. Në shumë raste, qeveritë shërbejnë si risigurues. Politika publike shpesh dikton mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave dhe shumë karakteristika të programit. Në fund, politika publike mund të ndikojë edhe në vëllimet e portfolios.

Qeveritë mund të ofrojnë edhe shërbime të ndalimit të humbjes. Aktivitetet e ndalimit të humbjeve i referohen situatave në të cilat (zakonisht) një qeveri pranon humbje të sigurimeve përtej një niveli të caktuar. Në shumë raste, ofruesit e sigurimeve dhe risiguruesit nuk do të ofrojnë produkte të sigurimeve në mungesë të marrëveshjeve për ndalimin e humbjeve. Nivelet e ndalimit të humbjeve zakonisht janë rreth tre deri në pesë herë sa niveli total i primit. Në mungesë të marrëveshjeve për ndalimin e humbjeve, normat e primeve do të ishin më të larta për shkak të rrezikut të shtuar.

11.4.2.1. Përfshirja e Qeverisë. Kompanitë e sigurimeve i grupojnë polisat në kategori të ngjashme të rrezikut. Një mënyrë se si qeveritë përkrahin sigurimin bujqësor është duke risiguruar produktet ose prodhuesit me rrezik të lartë. Qeveritë shpesh krijojnë një grup me rrezik të lartë në të cilën lejohen kompanitë primare të sigurimit që të vendosin një numër të kufizuar të polisave. Në përgjithësi, grupet me rrezik të lartë janë të kufizuara në më pak se 15% të totalit të detyrimeve. Të gjitha kompensimet që rrjedhin nga polisat e caktuara në grupin me rrezik të lartë të qeverisë paguhën nga qeveria.

Kompanitë e sigurimeve shpesh përdorin grupet me rrezik të lartë të qeverisë si një mënyrë për të risiguruar produktet dhe programet e reja të cilat shpesh është e vështirë të vlerësohen pa performancën historike, të dhënat, pjesëmarrjen dhe kontrollin e rrezikut moral. Programet e sigurimeve bujqësore të zhvilluara mirë shpesh i japin më pak se 10% të detyrimeve totale grupeve të qeverisë me rrezik të lartë. Produktet e reja kanë më pak gjasa të zhvillohen nëse grupet me rrezik të lartë nuk sigurohen nga qeveritë.

Nëse qeveritë nuk i risigurojnë të gjitha polisat, programet e sigurimit të kulturave bujqësore duhet të jenë të arsyeshme nga ana aktuariale nëse rreziku do të pranohet nga një risigurues privat. Pra, polisat duhet të përmbajnë procedura të rrepta të nënshkrimit të marrëveshjes për ta shmangur rrezikun moral, përzgjedhjen e pafavorshme dhe mashtrimin. Disa rreziqe mund të jetë e nevojshme të përjashtohen dhe normat e primit duhet të jenë të arsyeshme nga ana aktuariale.

11.4.2.2. Cilësia e të dhënave. Për të tërhequr kompanitë e risigurimit, siguresit primarë duhet të identifikojnë qartë shpeshtësinë e humbjeve në rendimente dhe shkaqet e tyre. Këto masa duhet të jenë të matshme që risiguruesi të jetë i interesuar për pranimin e rrezikut shtesë. Qeveritë shpesh janë burimi i shumë të dhënave bujqësore të nevojshme për qëllime të sigurimit. Nëse nuk ka të dhëna të cilësisë së lartë, risiguruesit mund të rrisin ngarkesat e normës.

11.5 Politikat tregtare dhe ndërkombëtare

Programet bujqësore analizohen për pajtueshmërinë me marrëveshjet ndërkombëtare të tregtisë, përfshirë OBT/GATT (Organizata Botërore e Tregtisë/Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë). Marrëveshjet tregtare të OBT-së e kufizojnë shumën e ndihmës bujqësore sipas shtetit. Në përgjithësi, programet e rrjetit të sigurisë siç janë programet e sigurimit të kulturave bujqësore ose programet e

fatkeqësive nuk e deformatojnë tregun dhe nuk llogariten drejt kufijve të përkrahjes, por këto programe duhet të respektojnë disa rregulla të caktuara. Me rëndësi është se programet e tilla duhet të përkrahin të ardhurat e fermave në të gjitha ndërmarrjet dhe mund të zbatohen vetëm kur të ardhurat e fermës bien nën 70% të një mesatareje lëvizëse pesëvjeçare të fermës. Shumica e programeve të përkrahjes për bujqësi nuk e plotësojnë këtë kërkesë, kryesisht për shkak se ato janë specifike për produktin. Megjithatë, nëse këto subvencione përfaqësojnë më pak se 5% të vlerave të kulturave bujqësore në baza kombëtare, atëherë ato konsiderohen subvencione *de minimis* dhe nuk llogariten si pjesë e programit të brendshëm të përkrahjes bujqësore të një shteti. Edhe pse të mëdha, shpenzimet nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanada për subvencionet e sigurimit të kulturave bujqësore nuk e tejkalojnë objektivin *de minimus*. Negociatat aktuale të OBT-së përfshijnë një propozim për ta ulur limitin *de minimus* në 2.5%.

Disa vende të Bashkimit Evropian përkrahin programet e sigurimit të kulturave bujqësore (p.sh. Italia dhe Spanja). Që nga viti 2001, Komisioni Evropian ka hulumtuar mundësitë e BE-së për sigurimin bujqësor duke përfshirë subvencionimin e primeve.



12.0 Marketingu dhe menaxhimi i programit

Çështjet kryesore në lidhje me menaxhimin e programit përfshijnë pjesëmarrjen e prodhuesve, grupimin e sigurimeve dhe vendimmarrjen e përgjithshme të menaxhimit të biznesit. Standardizimi i këtyre proceseve është një element i rëndësishëm për menaxhimin, transparencën dhe risigurimin efektiv.

12.1 Marketingu

Përplekjet e marketingut duhet të dizajnohen në mënyrë që përfitimet nga blerja e sigurimit të kulturave bujqësore të jenë të qarta dhe të përcaktuara mirë. Rrjedhimisht, detajet e secilit produkt të sigurimit të kulturave bujqësore duhet të shpjegohen me kujdes dhe të theksohen. Përveç kësaj, fushatat e marketingut duhet të mundësojnë edukimin aktual dhe të ardhshëm për produktet. Marketingu duhet at përshkruajë qartë transparencën e produkteve të sigurimit për të krijuar besim në programet e sigurimeve bujqësore. Për këtë qëllim, politikat e korrigjimit të humbjeve duhet të përshkruhen me kujdes. Procesi i arkëtimit të primeve, përditësimet e sipërfaqes dhe afateve të mbjelljes duhet të kuptohen qartë nga prodhuesit. Përveç kësaj, rregullat, çështjet e menaxhimit të programit dhe procedurat e zgjidhjes së kontesteve duhet të jenë të dukshme në të gjithë literaturën e marketingut. Programi i marketingut duhet të përfshijë një shumëllojshmëri të mediave të shpërndarjes, duke përfshirë kontaktin personal, materialet e shkruara dhe burimet në internet.

Proceset për shitjen e kontratave të sigurimit duhet të marrin në konsideratë një sërë pyetjesh duke përfshirë:

- A duhet të certifikohen agjentët e shitjes për të treguar se i kuptojnë produktet që po shesin?
- A duhet që të gjithë agjentët e shitjes të ofrojnë secilin produkt përfshirë ato të favorizuara apo të zhvilluara nga kompanitë konkurruese?

Ndërtimi i besimit në programet e sigurimit të kulturave bujqësore kërkon:

- Respektimin e një grupi të caktuar parimesh;
- Përbushjen e objektivave të palëve të interesuara;
- Sigurimin e transparencës, konsistencës, barazisë dhe drejtësisë në zgjidhjen e kontesteve;
- Përmirësimin e proceseve afariste për ta përmirësuar efektivitetin e kostos.



rëndësishëm për ndërtimin e besimit në sistemet e sigurimit të kulturave. Sistemet kanadeze dhe amerikane theksojnë parimet e ngjashme:

- Qëllime dhe objektiva të qarta të programit;
- Transparenca dhe konsistenca;
- Barazia dhe drejtësia;
- Përfaqësimi i palëve të interesuara;
- Profesionalizmi dhe kompetenca.

12.1.1. Transparenca e programit nënkupton që proceset dhe produktet të jenë të kuptueshme dhe sa më pak të komplikuar që të jetë e mundur. Për shkak se sigurimi bujqësor është kompleks nga vetë natyra e tij, duhet të bëhen përpjekje për t'i thjeshtuar dhe shpjeguar qartë procedurat, objektivat, proceset dhe produktet.

Shembull: Kur paraqiten produkte të reja kanadeze, përgatiten materialet e shtypura që përshkruajnë çdo aspekt të produktit të ri. Në proces, diskutohen përparësitë dhe mangësitë e produktit si dhe përdorimi i përshtatshëm dhe i papërshtatshëm. Përveç kësaj, agjentët e sigurimeve marrin dokumente, informacion dhe kalojnë nëpër trajnim. Agjentët caktojnë takime me klientët e tyre për ta diskutuar produktin e ri dhe për të shpërndarë materiale informative. Në fund, prodhuesit dhe agjentët mund të kontaktojnë me agjencinë që po e paraqet produktin e ri nëse kanë pyetje. Këto përpjekje u japin pjesëmarrësve njohuritë e nevojshme për marrjen e vendimeve të mira dhe zvogëlimin e numrit të kontesteve.

12.1.2. Konsistenca e programit kërkon që programet dhe produktet të jenë të pajtueshme, në harmoni dhe në përputhje me parimet, objektivat dhe qëllimet e miratuara.

Konsistenca e dizajnit të produktit nënkupton që:

- Dizajni i produkteve është i standardizuar në të gjitha firmat e sigurimeve;
- Kontratat e sigurimit, proceset e aplikimit dhe procedurat e nënshkrimit janë të standardizuara;
- Mbledhja e të dhënave është e koordinuar dhe e standardizuar;
- Korrigjimi i humbjeve dhe proceset e zgjidhjes së kontesteve janë të standardizuara;
- Metodatat e sakta prezantohen në aktivitetet e edukimit;
- Materiali i shkruar është dizajnuar për të përmirësuar ndërveprimet ndërmjet agjentëve të shitjes dhe prodhuesve;
- Ekzistojnë qendrat e thirrjeve për fermerët dhe agjentët e shitjes;
- Trajnimi i personelit të sigurimeve është i koordinuar;
- Proceset formale janë përgatitur për të dokumentuar përmirësime të vazhdueshme në arsim, njohuri dhe efikasitet.

12.2 Pjesëmarrja e prodhuesit

Bujqit janë konsumatorët e produkteve të sigurimit të kulturave bujqësore. Që një program sigurimi bujqësor të jetë i suksesshëm, ai duhet t'i plotësojë kërkesat e këtyre konsumatorëve. Kënaqësia e bujqut do të varet shumë nga shkalla në të cilën programi i trajton disa faktorë.

12.2.1. Identifikimi i Produktit. Prodhuesve duhet të ofrohen produkte që i ndihmojnë ata ta menaxhojnë rrezikun. Identifikimi i nevojave të prodhuesve mund të bëhet në mënyra të ndryshme.

Organizatata e fermave luajnë një rol në bartjen e nevojave të prodhuesve të industria e sigurimeve. Për shembull, para vitit 1990, nuk ka pasur sigurim për prodhimin e boronicave në Shtetet e Bashkuara. Delegacionet e Kongresit që përfaqësonin prodhuesit e boronicave në Uiskonsin dhe Masaçusets, kërkuan nga Agjencia e Menaxhimit të Rrezikut (RMA) e USDA-së të krijojë një produkt për të ndihmuar menaxhimin e rrezikut të rendimentit për boronicat.

Një shembull tjetër ofrohet nga prodhuesit e elbit për malt në SHBA që donin një produkt për t'ju ndihmuar në menaxhimin e rreziqeve të cilësisë. Edhe pse ka pasur produkte të sigurimit individual për elbin si ushqim

për kafshë, sigurimi ekzistues i rendimentit nuk ulte rreziqet e cilësisë. Prodhuesit mund të korrnin rendiment mesatar të elbit të papërshtatshëm për malt për shkak të kushteve të motit. Si rezultat, prodhuesit bënë zbritje të çmimeve kur ishin të detyruar të shesin elbin për malt në tregun e elbit si ushqim të kafshëve. Grupet prodhuese kombëtare me sukses lobuan për një shtytës të cilësisë për produktet e sigurimit të prodhimit të elbit.

Agjencitë qeveritare të sigurimit të kulturave bujqësore bazohen në grupet e fokusit të fermerëve për të ndihmuar në orientimin e zhvillimit të produkteve të reja. Për shembull, AMR e USDA-së ka organizuar periodikisht grupet e fokusit të fermave për të diskutuar produktet e sigurimeve dhe krijimin e produkteve të reja. Këto grupe fokusi kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në hartimin e programit dhe kanë ndihmuar zhvillimin e produkteve të dëshirueshme.

Përveç kësaj, qeveria dhe organizatat bujqësore shpesh kontraktajnë konsulentë të cilët kanë ekspertizë të konsiderueshme në fiziologjinë, ekonominë dhe statistikat e bimëve për të zhvilluar produkte të reja.

12.2.2. Edukimi i prodhuesve. Një tjetër kriter i rëndësishëm për sukses përfshin edukimin e prodhuesve për produktet e sigurimit të kulturave bujqësore. Ky proces shpesh përfshin përkrahjen e qeverisë dhe bashkëpunimin me profesorët e universitetit, shërbimet e zgjerimit të bujqësisë dhe kontraktuesit privatë për të zhvilluar dhe ofruar informacion për sigurimin e kulturave bujqësore. Këto mundësi edukimi përfshijnë seminare të prodhuesve ku shpjegohen dizajni i produktit, zbatimi dhe softueri kompjuterik për vendimmarrje që u mundëson prodhuesve ta vlerësojnë vlerën e produkteve të sigurimit të kulturave bujqësore për punën e tyre. Përveç kësaj, fermerëve u jepen fletët e fakteve që i përshkruajnë produktet, afatet e regjistrimit dhe kërkesat e tjera të rëndësishme administrative dhe të pajtueshmërisë ose kurrikulën arsimore për përdorim personal në internet dhe CD.

Qeveria amerikane ndan 20 deri në 50 milionë dollarë në vit për edukim për sigurimet e kulturave bujqësore. Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja i kanë në cak popullatat me burime të kufizuara dhe jo të përfaqësuara sa duhet në shumicën e përpjekjeve të tyre edukative. Këto grupe në përgjithësi përbëhen nga prodhuesit relativisht të vegjël.

Kompanitë private të sigurimeve gjithashtu ofrojnë materiale edukative për agjentët e sigurimeve, dhe këta agjentë i edukojnë prodhuesit. Sidoqoftë, potenciali për konflikt të interesit sigurisht se ekziston në këto marrëveshje. Organizatat e fermave shpesh marrin fonde nga agjencitë qeveritare për t'i edukuar anëtarët e tyre.

12.2.3. Shitjet dhe regjistrimi. Programi i sigurimit bujqësor mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse fermerët blejnë produkte dhe regjistrohen në programet e sigurimeve. Palët e interesuara në këtë proces shpesh janë ofruesit privatë të sigurimeve primare dhe agjencitë qeveritare (sidomos nëse programi i sigurimit të kulturave bujqësore operohet dhe menaxhohet nga qeveria).

Në Shtetet e Bashkuara, çdo agjenci lëshuese e sigurimit të kulturave bujqësore duhet ta ofrojë të tërë gamën e produkteve për klientët. Disa organizata bujqësore janë gjithashtu agjenci lëshuese të sigurimit të kulturave bujqësore. Të gjitha shitjet e produkteve të sigurimit në Kanadë menaxhohen nga një agjenci qeveritare.



12.2.4. Arkëtimi i primeve. Një pikë tjetër e rëndësishme e kontaktit me klientët përfshin arkëtimin e primeve. Procedurat e arkëtimin të primeve duhet të përcaktohen qartë dhe të jenë funksionale. Komplikimi i pagesave të subvencioneve të qeverisë për primet duhet të jetë politikisht i pranueshëm, transparent dhe me ekonomik.

Arkëtimi bëhet në mënyra të ndryshme. Ofruesit privatë të sigurimit primar ose agjencitë qeveritare arkëtojnë primet (zakonisht neto nga subvencionet të cilat zakonisht paguhen nga qeveria direkt tek siguruesi). Këto prime mund të arkëtohen në momentin e blerjes ose pas korrjes (primet zbriten nga kompensimet e ardhshme). Nëse blerja ndodh në momentin e korrjes, duhet të vendosen rregulla për të garantuar që do të bëhen pagesat e primit.

Në disa vende, të tilla si Ukraina, prodhuesit e paguajnë të gjithë primin tek ofruesi privat i sigurimeve primare dhe më pas marrin subvencion në formën e rabatit, qoftë nga qeveria ose nga kompania private në një datë të mëvonshme.

12.2.5. Korrigjimi i humbjeve është me rëndësi të madhe për programet e suksesshme të sigurimeve. Ndërveprimi ndërmjet prodhuesve dhe korrigjuesve të humbjeve shpesh është plot me emocione që rezultojnë nga shqetësimet e prodhuesve lidhur me humbjet e fundit. Në këtë kohë prodhuesit nuk dëshirojnë të grinden me korrigjuesit mbi hollësitë dhe rezultatet e korrigjimit të humbjes. Historikisht, janë përdorur një sërë metodash për korrigjimin e humbjeve. Ofruesit privatë të sigurimeve primare munden rastësisht të zgjedhin korrigjuesit e humbjeve nga një grup individësh të certifikuar nga një agjenci qeveritare. Qeveria mund të lidhë kontrata me korrigjues të pavarur të humbjeve (në rastin ideal të mos kenë lidhje lokale) ose përdor punonjës të qeverisë. Përveç kësaj, ofruesit e sigurimeve primare private punësojnë korrigjuesit e humbjeve, ndërsa auditimet e rastësishme të performancës i kryen një agjenci qeveritare.

12.2.6. Pagesa e kompensimit. Një pikë tjetër kontakti ndërmjet programeve të sigurimeve dhe konsumatorëve ndodh kur lëshohen pagesat e kompensimit. Koha, saktësia dhe efikasiteti i pagesave të kompensimeve janë elemente thelbësore të programeve të mira të sigurimit. Ka shumë mënyra të ndryshme për të menaxhuar pagesat e kompensimit.

Korrigjuesit e humbjeve ndonjëherë i paguajnë kërkesat e vogla menjëherë (gati në terren). Kërkesat e mëdha shpesh paguhen në një datë të mëvonshme pas shqyrtimit. Ofruesit privatë të sigurimit primar mund t'i paguajnë të gjitha kompensimet pas një shqyrtimi, ose një agjenci qeveritare mund t'i paguajë të gjitha kompensimet. Kjo zakonisht bëhet kur një agjenci qeveritare është ofruesi i vetëm i sigurimeve (si në Kanada, për shembull). Gjithashtu është e mundur që të lejohen vetëm kompanitë e certifikuar të sigurimit për të ofruar shërbime të sigurimit të kulturave bujqësore. Kërcënimi i humbjes së certifikatës mund ta ofrojë një stimulim që kompanitë të ofrojnë shërbime të kompensimit të sakta, të drejta dhe me kohë.

12.2.7. Zgjidhja e kontesteve. Bizneset e suksesshme duhet të kenë procese të arsyeshme dhe të besueshme për zgjidhjen e kontesteve. Procedurat e zgjidhjes së kontesteve duhet të jenë transparente, të arritshme, të lira dhe të barabarta; këto procedura janë çelësi për zhvillimin e programeve të suksesshme të sigurimeve bujqësore. Sistemet efektive të zgjidhjes së kontesteve duhet të jenë lehtësisht të arritshme, të kuptuara dhe të përcaktuara mirë. Proceset që prodhuesit duhet t'i ndjekin për ta bërë rishikimin e

vlerësimeve fillestare të kërkesave duhet të jenë të qarta.

Programet e suksesshme duhet të angazhojnë një panel të pavarur shqyrtimi që përfshin prodhuesit e tjerë të trajnuar në nuancat e sigurimeve bujqësore duke përfshirë dispozitat specifike të kontratave dhe arsyet për korrigjimin e humbjeve dhe të inkurajojnë përfaqësimin profesional lokal apo “joformal”, në vend të përfaqësimit ligjor. Komisionet e rishikimit duhet të edukohen që t’i kuptojnë programet e sigurimeve bujqësore, kontratat, çështjet e menaxhimit të prodhimit. Këto komisione duhet të mos kenë konflikte të interesit dhe t’i kuptojnë situatat në hapësira të ndryshme.

Prodhuesve duhet t’u jepet mundësia për të apeluar rastet në mjedis jo kërcënues. Procedurat e apelit për ankesat dhe vendimmarrjen duhet të jenë të dokumentuara mirë, të përballueshme dhe me kohë. Vendimet duhet të përfshijnë arsye të qarta për rezultatin e dhënë dhe duhet të jepen menjëherë. Në fund, duhet të ruhen regjistrat e rishikimeve dhe kontesteve.



Për shembull, në Shtetet e Bashkuara, zgjidhjet e kontesteve që përfshijnë korrigjimet e humbjeve i ndjekin këto hapa:

- Fillimisht, prodhuesi duhet ta apelojë korrigjimin e humbjes te ofruesi privat i sigurimeve primare që e ka shitur dhe shërbyer kontratën. Prodhuesit mund të kërkojnë një opinion të dytë për korrigjimin e humbjes nga një korrigjues tjetër. Shumica e kontesteve zgjidhen në këtë nivel;
- Nëse një prodhues ende është i pakënaqur, ai/ajo e regjistron shkresën në Panelin për Zgjidhjen e Kontesteve;
- Anëtarët e Panelit për Zgjidhjen e Kontesteve merren nga një bazë e gjerë (përfaqësues nga fermat dhe organizatat e fermave, korrigjuesit e humbjeve, etj.). Anëtarët caktohen nga Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Rrezikut të USDA-së;
- Nëse një prodhues ende është i pakënaqur me rezultatin, ai ose ajo mund ta përdorë sistemin gjyqësor për ta zgjidhur kontestin. Megjithatë, sistemi gjyqësor në përgjithësi anon kah vendimet e Panelit për Zgjidhjen e Kontesteve, nëse nuk ka pasur gabime procedurale.

Megjithëse kontestet në korrigjimin e humbjeve janë realitet, ka gjasa të jenë më të shpeshta gjatë fazave të hershme të zhvillimit, pasi zbulohen mbikëqyrjet e nënshkrimit të marrëveshjes dhe prodhuesit mësojnë rreth procedurave, proceseve dhe produkteve. Rrjedhimisht, është e domosdoshme që proceset e zgjidhjes së kontesteve të zhvillohen plotësisht përpara se të ofrohen produktet e sigurimit të kulturave bujqësore.

12.3 Grupimi i sigurimeve primare

Ofruesit e sigurimeve i paguajnë risiguruesit ta pranojnë pjesën më të madhe të rrezikut që ata e shkaktojnë përmes shitjes së kontratave të sigurimit. Kostot e risigurimit janë më të ulëta nëse ofruesit e sigurimeve mund të grupojnë kontrata të ngjashme në përmasa të shumëfishta.

Për më tepër, grupimi i duhur është i nevojshëm për ta evituar erozionin e pjesëmarrjes. Prandaj, programet duhet ta lehtësojnë grupimin e kulturave bujqësore, përcaktimeve të rendimentit, rajoneve dhe praktikave të prodhimit. Në vlerësim duhet të njihet dallimi i rrezikut në këto grupe.

12.3.1. Kulturat bujqësore. Çdo lloj i kulturave bujqësore i ka vetitë unike për sigurimin e tyre. Dallimet në llojllojshmërinë e rendimenteve shkaktojnë që normat e primeve të ndryshojnë ndjeshëm në kulturat bujqësore dhe nënkategoritë e tyre. Përveç kësaj, shumë kultura bujqësore kanë dimensione cilësore që duhet të merren parasysh kur vendoset vlera për kompensim dhe shitje. Gjithashtu duhet të merren parasysh variacionet në datat e zakonshme të mbjelljes dhe praktikave të tjera kulturore. Për shembull, duhet të vendosen datat e ndalimit dhe të shtyrjes së mbjelljes.

12.3.2. Rendimenti. Vendosja e rendimenteve të pritura për çdo kulturë bujqësore ndikon gjithashtu në grupimin e sigurimeve. Të dhënat historike shpesh mungojnë ose nuk janë të plota. Të dhënat rajonale mund të mos jenë në korrelacion me aktivitetet specifike bujqësore. Matja e rendimenteve reale dhe procedurat e korrigjimit të humbjeve dallojnë varësisht nga kultura bujqësore dhe ofruesit e sigurimeve. Shpesh, rendimentet mund të maten në bazë të "lagësht" ose "të thatë" që ndikon në peshën e produktit bujqësor dhe, në fund të fundit, ndikon në llogaritjet e rendimentit. Në rastet e shqyrtimit të cilësisë, ekzistojnë dallime në kontratat e sigurimeve varësisht nëse do të bëhen korrigjime të cilësisë në rendiment ose çmime.

12.3.3. Hapësinore. Ka dallime të konsiderueshme rajonale në prodhimin e kulturave bujqësore. Praktikrat normale të prodhimit dallojnë sipas rajonit, si edhe rendimentet e pritura. Varietetet e ndryshme të kulturës së njëjtë shpesh mbillen në rajone të ndryshme për të përfituar nga kushtet atmosferike lokale. Përcaktimi i çmimeve të përdorura për kompensimin e kontratave të rendimentit dhe llogaritjen e vlerës në kontratat e të ardhurave ndryshojnë varësisht nga hapësira. Edhe brenda një rajoni ekzistojnë dallime të konsiderueshme bazë. Dallimet e klimës gjithashtu shkaktojnë variacion në faktorët e cilësisë në aspektin e përpunuesve të ushqimit dhe ushqimit të kafshëve. Kështu, çështjet hapësinore i komplikojnë aktivitetet e grupimit të sigurimeve.

12.3.4. Praktikrat e prodhimit. Praktikrat heterogjene të prodhimit shkaktojnë edhe sfida për grupimin e sigurimeve. Edhe brenda një rajoni mund të prodhohen disa lloje gruri (p.sh., pranveror, dimëror dhe durum). Secili mund të prodhohet në tokë të thatë ose sisteme të prodhimit me ujitje. Praktikrat e lëvrimit për secilin mund të shkojnë nga lëvrimi konvencional deri te lëvrimi i kufizuar, lëvrimi minimal, ose pa lëvrim. Secili prej këtyre sistemeve të lëvrimit mund të përdoret në bashkëpunim me ugar çdo të dytin vit, korrjen me përkulje, apo praktika të vazhdueshme të korrjes.

12.3.5. Madhësia e fermës. Fermat më të mëdha zakonisht kanë më pak luhatshmëri të rendimenteve dhe kosto më të ulët të shërbimit sesa fermat e vogla. Prandaj, normat e sigurimit të arsyeshme nga ana aktuariale janë më të ulëta për fermat më të mëdha. Megjithatë, ofrimi i normave më të ulëta për fermat më të mëdha shpesh është politikisht kontraverse.

12.4 Menaxhimi i biznesit

Një gamë e gjerë e funksioneve të biznesit duke përfshirë menaxhmentin, monitorimin dhe qeverisjen janë elemente të rëndësishme të industrisë së sigurimeve bujqësore. Qëllimi i menaxhmentit është koordinimi i funksioneve të biznesit të një kompanie sigurimesh bujqësore. Menaxhmenti supozohet të jetë "fytyra" e sistemit për prodhuesit dhe publikun. Ai përfaqëson integritetin e sistemit dhe organizon komunikimin dhe planifikimin strategjik.

Funksionet e monitorimit përfshijnë zbatimin e kontratave, identifikimin e subjekteve të transaksionit, ofertat e produkteve, limitet e mbulimit, të drejtën për sigurim, kapacitetin e rrezikut të firmave të sigurimeve dhe sistemit, raportimin publik, mbrojtjen e konsumatorit, certifikimin e agjentëve dhe firmave të sigurimit dhe menaxhimin e të dhënave.

Qeverisja përfshin vendimmarrjen në lidhje me strukturën dhe kulturën e një subjekti afarist. Veçanërisht, qeverisja përfshin planifikimin strategjik dhe përcaktimin e prioriteteve, pajtueshmërinë rregullative, sigurimin e saktësisë dhe qartësisë së kontratave të sigurimit, proceset operacionale dhe të komunikimit, menaxhimin financiar dhe dhënien e informacioneve shpjeguese publike, auditimin dhe menaxhimin e performancës. Së bashku këto funksione i lehtësojnë operacionet, administrimin dhe aktivitetet kontabël të një biznesi.

12.4.1. Operacionet. Filozofia operative, vlerësimi i programit, raportimi, monitorimi dhe mbikëqyrja janë elemente thelbësore të një programi të suksesshëm sigurimi bujqësor.

Filozofitë operative duhet t'u mundësojnë menaxherëve të mishërojnë dhe komunikojnë vizionin dhe filozofinë, të integrojnë funksionet e operacioneve në të gjithë sistemin, të vlerësojnë dhe trajtojnë pasardhësit, të planifikojnë dhe menaxhojnë njohuritë dhe të zhvillojnë procese që krijojnë dhe mbajnë integritet në të gjitha funksionet operative (p.sh., shitjet dhe korrigjimi i humbjeve).

Vlerësimi i suksesit të një programi të sigurimit të kulturave bujqësore kërkon krijimin e objektivave të matshëm për të krahasuar rezultatet me qëllimet fillestare dhe mbledhjen e të dhënave për të përkrahur objektivat. Vlerësimet duhet të përfshijnë monitorimin e rregullt të funksioneve kryesore operative (p.sh., korrigjimi i humbjeve, performanca e investimeve të primeve tepriç dhe zgjidhja e kontesteve) dhe të kryhen analiza të kostove/përfitimeve të strategjive përmirësuese sipas praktikave më të mira.

Raportimi dhe auditimet nga palët e treta nënkuptojnë përgjegjësisë publike (nëse përfshihet financimi qeveritar), kontabilitetin vjetor transparent të performancës, komunikimin e vazhdueshëm të hapur dhe efektiv me palët kryesore dhe publikun, auditimet nga palët e treta, rezervat e mjaftueshme financiare dhe rrjedhat e subvencioneve të primeve brenda sistemit.

Monitorimi i funksioneve afariste përfshin kryerjen e vlerësimeve të "sistemit" (shqyrtimi i proceseve të biznesit, pjesëmarrja e prodhuesve, koha e kërkesave dhe pagesave të primeve, reagimet ndaj fatkeqësive në prodhim, kërkesat e paguara kundrejt kërkesave të raportuara); vlerësimin e korrigjimeve të humbjeve (saktësia, pajtueshmëria me standardet, koha); dhe vlerësimin e performancës së individëve në firma (menaxhmenti dhe personeli tjetër).

Komisionet e mbikëqyrjes ose bordet e drejtorëve duhet të përfaqësojnë interesat e të gjithë aktorëve, kompanive të sigurimeve, qeverisë dhe klientëve. Komisioni ose bordi vendos kolektivisht për përgjegjësitë e qeverisjes, monitoron aktivitetet e menaxhimit, dhe komunikon me qeverinë, prodhuesit dhe

organizatat e sigurimeve. Komisioni duhet ta sigurojë integritetin, kompetencën dhe transparencën e sistemit.

12.4.2. Administrata. Menaxhmenti duhet ta ketë autoritetin për të ndërmarrë veprime në interes të përmbushjes së qëllimeve dhe përmbushjes së përgjegjësive fiduciare. Për sistemin e sigurimit të kulturave bujqësore është e nevojshme që të ketë burime të mjaftueshme për të realizuar strategjitë afariste, autorizimin për t'i caktuar personelit kompetent trajnimet dhe aftësitë e përshtatshme për të kryer detyrat, vlerësime të strukturuar të performancës me shpërblime, udhëzime dhe trajnime për përmirësim dhe proceset për auditimin e brendshëm dhe monitorimin për ta krijuar dhe mbajtur integritetin.

Detyra të tjera administrative janë koordinimi dhe zhvillimi i strategjisë afariste përmes dizajnit të produkteve konsistente dhe zhvillimit të standardeve operative (p.sh., korigjimit të humbjeve, nënshkrimit të marrëveshjeve), organizimi i menaxhimit të të dhënave dhe sistemeve të teknologjisë informative, dhe përcaktimi i prioritetëve. Administrata duhet ta koordinojë kërkimin dhe zhvillimin e produktit, të japë parashikime të qarta në lidhje me dorëzimin e produktit dhe të mundësojë monitorimin jo-konfrontues me qëllim të përmirësimit të biznesit (fokusimi i arsimit/trajnitimit).

12.4.3. Kontabiliteti. Sistemet e sakta, të besueshme dhe efikase të kontabilitetit janë kritike për menaxhimin dhe kontrollin e suksesshëm të një programi sigurimesh bujqësore. Sistemet e tilla duhet të kenë sisteme teknologjike, të biznesit, të raportimit dhe procedurat e auditimit të dizajnuara mirë dhe funksionale.

12.4.3.1. Sistemet e teknologjisë informative (TI). Programet e sigurimeve bujqësore duhet të kenë sisteme të TI të sakta, të sigurta, të arritshme, të siguruara me kopje rezervë dhe të zgjerueshme. Siç është rasti me shumë biznese, aktivitetet e TI janë thelbësore për programet e sigurimeve bujqësore. Shumica e sistemeve të TI-së të përdorura nga programet e sigurimeve bujqësore përdorin "Bazat e të dhënave relacionale" për shkak të sasisë së madhe të informacionit që procesohet. Baza e të dhënave relacionale karakterizohet me identifikuesit kryesorë të prodhuesve individualë (kontratat) që mund të lidhen përmes grupeve të të dhënave. Programet e sigurimeve bujqësore shpesh kërkojnë që variablat të përshtaten për të reflektuar kushtet aktuale. Duke pasur parasysh numrin e të dhënave që duhet të menaxhohen, një bazë të dhënash relacionale mundëson që ndryshimi në një element të bazës së të dhënave të pasqyrohet në të gjitha të dhënat.

Sistemet e TI duhet të mundësojnë qasje të lehtë në të dhëna. Një metodë e qasjes në të dhëna përdor sisteme automatike "Query Tools" që u mundësojnë klientëve t'i arrijnë ato të dhëna që janë më relevante për detyrat aktuale.

Menaxhimi i të dhënave përfshin përdorimin e numrave që përfaqësojnë, për shembull, të dhënat e rendimentit, informacionin e çmimeve, dhe korigjimet e humbjeve. Sidoqoftë, të dhënat duhet të menaxhohen edhe në lidhje me "Njohuritë dhe regjistrat" që nënkuptojnë regjistrimin dhe përcjelljen e vendimeve të marra nga ofruesit e sigurimeve. Njohuritë e krijuara me kalimin e kohës duhet t'u transferohen të tjerëve.

Sistemet e TI duhet gjithashtu të marrin në konsideratë mënyrat e shpërndarjes të përdorura për bartjen e informacionit të tjerët. Do të thotë, sistemet e TI duhet të përfshijnë elemente specifike të dizajnit nëse informacioni do të jetë i arritshëm përmes internetit, personalisht, ose i shtypur.

12.4.3.2. Sistemet afariste janë të nevojshme për ofrimin e sigurimeve bujqësore, dhe përfshijnë procedurat operative që mundësojnë menaxhimin e:

- Shitjeve, aplikacioneve, nënshkrimeve dhe kontraktimeve;
- Llogaritë e arkëtueshme - sistemet e faturimit dhe arkëtimit (prodhuesi, qeveria, risigurimi);

- Llogaritë e pagueshme - vlerësimi i ankesave (korrigjimi i humbjeve, përpunimi, zgjidhja e kontesteve, dokumentacioni);
- Raportimi - treguesit financiarë dhe të performancës.

12.4.3.3. Procedurat e raportimit nuk duhet të jenë arbitrare. Ato duhet të jenë të qarta, konsistente, të përcaktuara mirë, të sakta, objektive dhe të planifikuara.

Sistemet e raportimit shpesh janë përgjegjësi e një komisioni mbikëqyrës ose bordi të drejtorëve që përfshin përfaqësimin nga aktorët kryesorë, përfshirë përfaqësuesit e firmave të sigurimeve, qeverisë, fermerëve dhe publikut. Raportimi duhet të përfshijë çështjet që lidhen me zhvillimin e biznesit, shpërndarjen e programeve, politikat, ndarjen e kostos dhe pajtueshmërinë rregullative.

12.4.3.4. Funkcionet e auditimit përfshijnë auditimet e brendshme dhe të jashtme. Auditimet e brendshme kryhen nga ofruesit e sigurimeve dhe auditimet e jashtme kryhen nga palë të treta të kualifikuara. Auditimet i vlerësojnë aspektet operacionale të sistemeve të biznesit si një kontroll i paanshmërisë, saktësisë dhe integritetit.

Auditimi i brendshëm është mjet menaxhimi që rishikon funksionet e biznesit siç janë qeverisja, proceset operative, dokumentacioni i politikave, zbatimi i kontratave, saktësia e faturimit, rezultatet e vlerësimit të primeve dhe procesimi i kërkesave.

Përveç kësaj, auditimet mund të identifikojnë çështjet dhe të bëjnë përmirësime në proceset e sistemit dhe të përcaktojnë problemet që mund të dalin gjatë auditimeve të jashtme nga palët e treta.

Auditimet e jashtme nga palët e treta kryhen nga vëzhgues të jashtëm të paanshëm dhe janë të dizajnuara për të dhënë një rishikim të pavarur të praktikave të biznesit dhe stabilitetit financiar dhe për ta vlerësuar procesin e arkëtimit të primeve, sistemet e menaxhimit të të dhënave, mbajtjen e regjistrave, saktësinë dhe zbatimin konsistent të rregullave dhe procedurave. Auditimet nga palët e treta japin rekomandime për menaxhmentin dhe rregullatorët dhe shqyrtojnë progresin në trajtimin e problemeve nga auditimet e mëparshme. Proceset e auditimit nga palët e treta duhet të organizohen në mënyrë që auditimet e shumta të jenë të panevojshme.

Auditimet nga palët e treta, të cilat shpesh kërkohen nga agjencitë rregullative, shpesh kërkojnë pjesëmarrje të konsiderueshme nga menaxhmenti sepse auditorët e jashtëm zakonisht nuk i kuptojnë sigurimet e kulturave bujqësore. Prandaj, duhet të bëhen përpjekje shtesë për të ofruar trajnime. Sistemet e mira të sigurimeve bujqësore duhet të kryejnë auditime vjetore nga palët e treta që kanë si rezultat raporte vjetore publike që e zhvillojnë dhe mbajnë integritetin e sistemit.

13.0. Komente si përmbledhje

Zhvillimi, zbatimi dhe suksesi i programeve të sigurimeve bujqësore kërkojnë shumë koordinim, bashkëpunim dhe vizione të përbashkëta. Qëndrueshmëria financiare varet nga ofrimi i produkteve të dëshiruara nga prodhuesit. Përveç kësaj, primet duhet të jenë të duhura dhe të përdoren sistemet transparente të menaxhimit të biznesit. Në shumë raste, përfshirja e qeverisë është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve rregullative dhe/ose rezervave financiare ose subvencioneve. Përveç kësaj, burimet njerëzore me ekspertizë specifike duhet të zhvillohen para zbatimit të një programi të sigurimeve. Kapacitete të konsiderueshme njerëzore kërkojnë në ministritë qeveritare, rregullatorët e sigurimeve, kompanitë private të sigurimeve dhe organizatat e prodhuesve. Shumë nga këto aftësi janë specifike për sektorin e sigurimeve bujqësore.

Sistemet e sigurimeve bujqësore përfshijnë elemente të shumta që duhet të koordinohen me kujdes. Për ta tërhequr interesin e risiguruesve, grupi i kompanive agro-siguruese duhet shpesh të dakordohen të tregojnë produkte të ngjashme të sigurimit. Bankat dhe ofruesit e tjerë të faktorëve shpesh përfshihen në shitje të agro-sigurimeve sepse kjo e minimizon rrezikun kreditor dhe përmirëson qasjen e prodhuesve në financim. Duhet të ketë sisteme juridike të zbatimit të kontratave që programet e tilla të zhvillohen. Gjithashtu, bashkëpunimi ndërmjet grupeve të ndryshme duhet të përqendrohet në një vizion dhe rezultat të përbashkët. Në fund, trajnimi dhe zhvillimi i sistemeve duhet të jenë produkt i përpjekjeve të konsiderueshme për zhvillimin dhe paraqitjen e produkteve të agro-sigurimeve në një treg.



Informatat e kontaktit:
International Finance Corporation
2121 P ennsylvania avenue, NY
Washington, DC 20433, USA
www.ifc.org

